



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.6(455)

QERSHOR 2026

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtore: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

REPORTAZH

SKËNDERBEGASIT NË VENDLINDJEN E SKËNDERBEUT



Nga Kol.Trifon LLUPO

FAQE 6

RADIO "JEHONA E SHQIPES"

40 VJET ZË I SHQIPTARIZMËS NË BRUKSEL



Halil RAMA – Mjeshtëri i Madh

FAQE 9

CEREMONIA

HISTORIA E FAMILJES ZEMZADE KU QËNDROI PËR NJË VIT MISIONI USHTARAK ANGLEZ



Musa Ricku

FAQE 4

OBVLP DHE SHOQATA E AVIATORËVE SHQIPTARË, AKADEMI PËRKUJTIMORE NË 100-VJETORIN E LINDJES

EDIP OHRI, LEGJENDA QË JETOI MES QIELLIT DHE VUAJTJES

OPINION

KOSOVA NË NATO, KËSHTJELLË E INTERESAVE TË SHBA NË RAJON

Gjeneral © Piro Ahmetaj

FAQE 11

HOMAZH

NOVRUZ ZEJNATI, STUDIUES I PASIONUAR, HISTORIAN DHE SHKRIMTAR I SHQUAR

FAQE 12

IN MEMORIAM

VILHELME VRANARI GRUAJA QË I SHNËRROI VUAJTJET NË ART

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 14

HOMAZH

LAMTUMIRË MIKU DHE KOLEGU YNË ELMAZ LEÇI

Nexhbedin Basha

FAQE 13



• Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku Çarkaxhiu foli për dimensionin moral të figurës së tij dhe të brezit të ushtarakëve që shërbyen me disiplinë, sakrificë dhe pa kërkuar lavdi personale

Nga Nexhbedin BASHA


FAQE 2

REAGIMI/ OBVLP MBËSHTET PROTESTËN E STUDENTËVE
SHQIPTARË NË MAQEDONINË E VERIUT

FAQE 5

PROFIL

SAKIP CAMI NË LIBRIN "PORTRETE SHKRIMTARËSH" TË ZEKERIA IDRIZIT



Nexhbedin Basha

FAQE 15

Zekerija Idrizi: Nga libri im 10 vëllimësh shqip-anglisht "Portrete shkrimtarësh"

FJALA

STRATEGU QË DREJTOI NGRITJEN DHE MODERNIZIMIN E AVIACIONIT SHQIPTAR

Gjeneral brigade Astrit JAUPI FAQE 3

FJALA

KOMANDANTI QË FITONTE RESPEKT JO ME FJALË, POR ME VEPRRA

Prof.asoc.dr. Bernard Zotaj FAQE 3

FJALA

NJË NGA FIGURAT MË TË SPIKATURA TË LIDERSHIPIT USHTARAK

Kolonel Luan SADIKU - Zëvendës Komandant i Forcës Ajrore FAQE 3

HISTORIA

DOM SHTJEFËN KOSTANDIN GJEÇOVI VEPRIMTAR I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Xhemal Meçi - "Mjeshtëri i Madh" FAQE 3

82-VJETORI

BRIGADA XV SULMUESE U PAGËZUA NË OPERACIONIN E QERSHORIT 1944

FAQE 10

ESSE

INVALIDI I UÇK -së I FIKSUAR NË NJË FOTOGRAFI NË SHESHIN "SKËNDERBEJ"?

Nga Sefer PASHA


FAQE 7

SPECIALE

OBVLP DHE SHOQATA E AVIATORËVE SHQIPTARË, AKADEMI PËRKUJTIMORE NË 100-VJETORIN E LINDJES

Edip Ohri, legjenda që jetoi mes qiellit dhe vuajtjes

- *Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku Çarkaxhiu foli për dimensionin moral të figurës së tij dhe të brezit të ushtarakëve që shërbyen me disiplinë, sakrificë dhe pa kërkuar lavdi personale*



Nexhbedin BASHA
Poet, Gazetar profesionit

Më datë 8 maj 2026, në sallën e bibliotekës së Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në ditën e lindjes së Edip Ohrit, u zhvillua Akademia përkujtimore kushtuar 100-vjetorit të lindjes së tij; pilotit, ushtarakut të karrierës, komandantit dhe figurës emblematike të aviacionit shqiptar, birit të Strugës.

Aktiviteti, i organizuar nga Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës në bashkëpunim me familjarët dhe Forcat Ajrore Shqiptare, mbledhi së bashku pilotë, ish-komandantë të aviacionit, gjeneral, historianë, gazetarë, ushtarakë veteranë, miq e të afërm të familjes Ohri. Ishte një takim që nuk kishte vetëm solemnitetin e një ceremonie, por ngrohtësinë e një rikthimi në kujtesë të një njeriu që la gjurmë të pashlyera në historinë e aviacionit shqiptar.

Nën moderimin me profesionalizëm të gazetarit Halil Rama, "Mjeshtër i Madh", Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës dhe kryeredaktor i gazetës "Veterani", ceremonia nisi me tingujt e Hymnit Kombëtar. Në sallë mbretëroi heshtja.



Me përvojën e tij të gjatë në gazetari dhe në organizimin e aktiviteteve përkujtimore e patriotike, Halil Rama i dha ceremonisë seriozitet, ritëm dhe ngrohtësi njerëzore, duke e kthyer këtë akademi në një homazh dinjitoz për figurën e Edip Ohri.

Më pas, në ekran u shfaq dokumentari-reportazh "Edip Ohri, Legjendë e Aviacionit", realizuar nga Merita Dulatahu. Pamjet sollën Strugën dhe liqenin e Ohrit; vendlindjen e tij, aty ku nisën rrënjët e familjes patriotike Ohri, për të cilën banorët shpreheshin me emocion se vetëm pas viteve të demokracisë e njohën dhe e kuptuan madhësitinë e tij.

Dokumentari ndoqi rrugëtimin e tij nga shkollimi në Strugë, te Normaleja e Elbasanit, pjesëmarrjen në Luftën Nacionalçlirimtare dhe më pas formimin profesional si pilot në Jugosllavi e Moskë, duke u kthyer në një nga figurat themeluese të aviacionit shqiptar.

Në ekran u shfaqën dëshmi për 20 vite shërbim në aviacion, ku ai kontribuoi në futjen dhe menaxhimin e të gjitha llojeve të avionëve të kohës dhe në marrëveshjet teknike me Kinën dhe Bashkimin Sovjetik. Ai u kujtua si komandant i qetë,

i disiplinuar, kërkues ndaj vetes dhe i drejtë me vartësit; autoritar në vendimmarrje, por njerëzor në marrëdhënie.

Në mënyrë të veçantë u soll në vëmendje edhe historia e birësimit të tij nga Qazim bej Vlora, i biri i Ismail Qemalit, Kryeministrit të parë të Shqipërisë dhe themeluesi i Pavarsisë. Megjithatë, ai ruajti mbiemrin Ohri si identitet të pandarë të jetës së tij.

Por rruga e tij njohu edhe dramën e madhe. Në kulmin e karrierës, në moshën 49-vjeçare, u li-rua nga detyra dhe më 16 tetor 1980 u arrestua në ditën e lindjes së Enver Hoxhës, me akuzën e rëndë politike. Në janar 1981 u dënua me 14 vite burg politik, ku kreu 10 vjet. Për shkak të amnistisë. Vuajti dënimin në Ballsh, Zejmen dhe më pas në Burgun e Burrelit.

Në vlerësime për Edip Ohrin, Gjeneral Lejtnant Rrahman Parllaku, ish Kryetar i OBVL ka vlerësuar rolin e tij si organizator dhe strateg i rrallë në strukturimin, reformimin dhe modernizimin e aviacionit, duke siguruar furnizimin teknik me avion e paisje të tjera, për dekada. Për këtë kontribut, ai është nderuar me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" nga ish Presidenti i Republikës Bujar Nishani.

VLERËSIMET NGA GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU, TATJANA PARLLAKU, KOL. LUAN SADIKU, PROF. BERNARD ZOTAJ E PROF. PËLLUMB XHUFË

Në aktivitetin për nder të 100-vjetorit të lindjes së Edip Ohrit foli edhe Manushaqe Shehu, e cila u shpreh se për të folur për komandant Edip Ohri "duhet përgjegjësi, maturi dhe ndjenjë e thellë nderimi", duke e cilësuar atë një nga komandantët legjendarë të historisë së Forcave të Armatosura shqiptare.

Edhe Prof. Benard Zotaj e përshkroi si një legjendë të gjallë, ndërsa Prof. Pëllumb Xhufi, historian, solli kujtime personale, duke theksuar se ai u nda nga jeta me faqe të bardhë, pavarësisht dramës së madhe që e shoqëroi.

Tatjana Parllaku u ndal te dimensionin moral i figurës së tij dhe i brezit të ushtarakëve që shërbyen me disiplinë, sakrificë dhe pa kërkuar lavdi personale. Në Akademinë përkujtimore foli edhe



FJALA

EDIP OHRI, STRATEGU QË DREJTOI NGRITJEN DHE MODERNIZIMIN E AVIACIONIT SHQIPTAR

Gjeneralbrigade Astrit JAUPI

Eshtë nder që në emër të Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë t'ju përsërisë e të kujtojmë e respektojmë ditën e lindjes së komandantit legjendar kol. Edip Ohrit.

Ne kujtojmë e përulëmi para figurës dhe veprimtarisë së tij në drejtimin e Aviacionit.

Partizani 17 vjeçar lindi dhe u edukua në një familje patriotike. U shkollua në shkollat më të mira, në Strugë, në Normalen e Elbasanit, në Shkollat e Aviacionit në ish-Federatën Jugosllave, ish-Bashkimin Sovjetik e në Republikën e Kinës; në Akademitë ushtarake të ish-Bashkimit Sovjetik e Tiranë.

Edip Ohri u dallua që në moshë të re për mençurinë, vizionin për të ardhmën. Ai ishte një strateg që udhëhoqi modernizimin dhe rritjen në nivel bashkëkohor të Aviacionit shqiptar.

Drejtoi me mençuri e aftësi tre faza të zhvillimit të aviacionit.

1. Arsimimin e personalit si jashtë vendit dhe krijimin e Shkollës së Aviacionit;

2. Përkushtimin në ngritjen e infrastrukturës në pista, krijimin e oficinave e uzinës së aviacionit, etj.

3. Krijimin e katër regjimenteve luftarake në Kuçovë, Rinas, Farkë e Gjadër...



Ishte simboli jonë dhe ne ndoqëm me kujdes rrugën e ndritur të komandant Edipit. Gjatë jetës u përball edhe me probleme, deri dhe dënimin e padrejtë me burg, të cilin e përballoi me dinjitet duke mbetur

një personalitet që nderohej e respektohej nga të gjithë aviatorët. Komandant Edipi mbetet krenaria dhe frymëzuesi i brezit të ri të aviatorëve shqiptarë.

I përjetshëm kujtimi i tij



Një nga figurat më të spikatura të lidërshiptit ushtarak

Kolonel Luan SADIKU

Zëvendës Komandant i Forcës Ajrore

Edip Ohri mbetet një nga figurat më të spikatura të lidërshiptit ushtarak në historinë e Aviacionit Shqiptar. Roli i tij nuk lidhet vetëm me drejtimin administrativ të aviacionit, por mbi të gjitha me vizionin, profesionalizmin dhe aftësinë për të ndërtuar një forcë ajrore moderne për kohën.

Në periudhën kur ai drejtoi Aviacionin Luftarak, Shqipëria po hidhte hapat e parë drejt krijimit të një aviacioni të mirëfilltë ushtarak. Edip Ohri ishte ndër drejtuesit që kuptoi rëndësinë strategjike të fuqisë ajrore dhe punoi për ta kthyer aviacionin në një nga komponentët më të rëndësishëm të mbrojtjes së vendit. Nën drejtimin e tij u konsoliduan strukturat komanduese, u rrit niveli i stërvitjes së pilotëve dhe u vendosën standarde të larta sigurie e disipline në fluturim.

Një nga meritat kryesore të tij ishte modernizimi i flotës ajrore. Gjatë kësaj periudhe, aviacioni shqiptar kaloi nga avionët me helikë tek avionët reaktivë MIG, duke hyrë në një epokë të re teknologjike. Ky transformim kërkonte jo vetëm pajisje moderne, por edhe përgatitje të avancuar të pilotëve dhe personelit teknik. Edip Ohri i kushtoi rëndësi të veçantë formimit profesional, duke kërkuar që kuadrot e aviacionit të ishin të aftë teknikisht, të disiplinuar dhe të përgatitur për çdo situatë operative. Ai pati rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin e infrastrukturës ajrore ushtarake. Në kohën e tij u fuqizuan baza ajrore strategjike si Kuçova, Farka, Rinas dhe Gjadri, të cilat u kthyen në qendra kryesore të operacioneve dhe stërvitjes ajrore. Këto baza përfaqësonin jo vetëm kapacitete ushtarake, por edhe simbol të zhvillimit të aviacionit shqiptar.

Si lider, Edip Ohri njihej për karakterin e fortë, disiplinën dhe kërkesën e lartë ndaj vartësve, por njëkohësisht edhe për kujdesin ndaj pilotëve dhe personelit. Ai gëzonte respekt të madh në radhët e aviatorëve, sepse ishte vetë pilot aktiv dhe njihte nga afër vështirësitë e profesionit. Përvoja e tij në fluturim dhe aftësia për të marrë vendime të shpejta e bënë një figurë autoritare dhe të besueshme.

Megjithëse më vonë u godit nga zhvillimet politike të kohës dhe u dënua gjatë periudhës së diktaturës, figura e tij vazhdon të vlerësohet si një nga themeluesit dhe arkitektët kryesorë të Aviacionit Luftarak Shqiptar. Në historinë e Forcës Ajrore, ai kujtohet si një lider me vizion, që kontribuoi në ngritjen profesionale dhe modernizimin e aviacionit shqiptar në një nga periudhat më të rëndësishme të tij.

Edip Ohri, më shumë se një pilot - Komandanti që fitonte respekt jo me fjalë, por me vepra

Prof.asoc.dr. Bernard Zotaj*

Sot nuk jemi këtu vetëm për të kujtuar një emër, por për të nderuar një jetë të tërë të vënë në shërbim të Shqipërisë.

Edip Ohri ishte më shumë se një pilot. Ai ishte një njeri që jetoj mes qiellit dhe tokës, duke i

dhënë kuptim fjalës përkushtim. Në kabinën e avionit, mes zhurmës së motorëve dhe përgjegjësisë së madhe, ai mbante jo vetëm drejtimin e fluturimit, por edhe besimin e një vendi të tërë. Me mijëra orë fluturimi, me dhjetëra pilotë të formuar prej tij, ai nuk ndërtoi vetëm një karrierë, por një brez të tërë aviatorësh. Ai ishte udhëheqës që printe me shembull, komandant që fitonte respekt jo me fjalë, por me vepra.

Nën drejtimin e tij, aviacioni shqiptar njohu zhvillim të ndjeshëm, si në rritjen e kapaciteteve ajrore, ashtu edhe në ndërtimin e infrastrukturës kryesore të kësaj arme. Ai përfaqësoi me dinjitet shtetin shqiptar edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare ushtar-

ake, duke qenë pjesë e delegacioneve të rëndësishme të kohës.

Por jeta e tij nuk ishte vetëm ngritje. Ai njohu edhe vështirësi, padrejtësi, kohë të errëta. Dhe megjithatë, nuk humbi kurrë dinjitetin. Nuk humbi kurrë dashurinë për njerëzit, për aviacionin, për Shqipërinë.

Kjo është madhështia e vërtetë e një njeriu: të qëndrojnë i drejtë edhe kur koha përkulet. Sot, kur përmendim emrin e Edip Ohrit, ne kujtojmë jo vetëm një pilot të madh, por një karakter të fortë, një mendje të kthjellët dhe një zemër të madhe.

Por mbi të gjitha, Edip Ohri mbetet një figurë njerëzore me vlera të larta: i urtë, i drejtë dhe i përkushtuar ndaj njerëzve dhe vendit të tij. Edhe në periudhat më të vështira të jetës, ai ruajti dinjitetin dhe dashurinë për aviacionin dhe për Shqipërinë.

*** Përsëritje nga Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake, për 100 vjetorin e lindjes të komandantit legjendë të Aviacionit Luftarak Edip Ohri**



CEREMONIA

Lufta e klasave goditi pa mëshirë familjen patriotike të Xhelil Zemzades ku qëndroi për një vit misioni ushtarak anglez gjatë Luftës së Dytë Botërore

HISTORIA E FAMILJES ZEMZADE KU QËNDROI PËR NJË VIT MISIONI USHTARAK ANGLEZ

Nga Musa RIÇKU

• **Nënkolonel Devis Strong:** *Mbretëria e Bashkuar është e nderuar të njoh faktin që shtëpia e Xhelil Zemzades në Limjan shërbeu si bazë për forcat Aleate Britanike dhe Anglo-Amerikane që vepronin në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht midis gushtit 1943 dhe majit 1944. Në një periudhë pushtimi dhe kur rreziku personal ishte gjithmonë i pranishëm, mbështetja e afruar nga familja juaj përfaqësonte një akt të jashtzakonshëm trimërie dhe solidariteti në mbështetje të çështjes aleate...*



Kapllan Zemzadja, shoqëruesi i majorit anglez në vitin 1943



nga gushti i vitit 1943 e deri në maj të vitit 1944, afro një vit.

SHTËPIA E XHELIL ZEMZADES, BAZË E RËNDËSISHME PËR MISIONIN USHTARAK ANGLEZ


Shtëpia e Xhelil Zemzades u bë një bazë e rëndësishme për misionin ushtarak anglez, pasi këtu gjetën jo vetëm një mbështetje pa interes, siguri të plotë, bujari e mikpritje të vërtetë dibrane, por kryesore është se gjetën dhe një përkthyes të aftë që u duhej në takimet e shpeshta. Ky ishte Shefki Zemzade, kushëri i Xhelilit. Xhelil Zemzade, ose Xhili siç i thërrisnin shkurt të gjithë, lindi në fshatin Limjan, në vitin 1902, në një familje patriotike e atdhetare. Kishte kryer arsimin bazë siç ishte atëherë mejtepi. Në gusht-shtator të vitit 1920 mori pjesë me armë në dorë në luftën e përgjakshme kundër hordhive serbe, ku ishte pozicionuar së bashku me Ramadan e Sefer Zemzaden në vendin e quajtur "Rrafshja e Kabe".

Në vitin 1928 Xhili së bashku me Shefki Zemza-

den, Sejdi Riçkun, Ibish Riçkun, Zyber Kerën, Baftjar Shehun e të tjerë, nën drejtimin e Murat Kaloshit shkojnë me mision për mbajtjen e rendit e qetësisë në Shalë e Shoshë, ku qëndruan afro një muaj. Aktiviteti patriotik e atdhetar i Xhelil Zemzades, por dhe si shtëpi bujare e mikpritëse njihej kudo, ndaj zgjedhja e misionit anglez shtëpinë e tij, nuk ishte rastësore.

RIÇARD RIDELL U NIS PËR NË KONFERENCËN E MUKJES NGA SHTËPIA E XHELIL ZEMZADES

Për të marrë pjesë në Konferencën e Mukjes, 3-6 gusht të vitit 1943, Riçard Ridell u nis pikërisht nga shtëpia e Xhelil Zemza-



des. Sëbashku me të ishte edhe Shefki Zemzade si përkthyes i tij e vetë Xhelil Zemzade.

(Vijon në faqen 5)

HISTORIA

Historia për të cilën kishte ardhur në Dibër nënkolonel Devis Strong fillonte 83 vite më parë, në gusht të vitit 1943. Një ngjarje kjo që iu fsheh brezit të ri, ndonëse vlerësonte gjithë Dibrën edhe në sytë e të huajve. Në Shqipëri misionet ushtarake angleze ishin të pranishëm pranë shtabeve të luftës. Qëllimi tyre ishte të luftonin pa kompromis fashizmin dhe nazizmin si dhe të ndihmonin në pajtimin e forcave politike dhe të bashkoheshin të gjithë në këtë luftë të madhe e të përgjakshme.

Një mision ushtarak anglez erdhi edhe në Dibër. Në këtë mision bënë pjesë, kryetar Riçard Ridell me gradën major, Viktor Smith, Anton Simoks, Rigerald Hibert. Të gjithë këto ishin me gradën "major" kurse dy të tjerë, njëri amerikan e tjetri polak me gradën "to-ger". Kryetari i këtij misioni anglez së bashku me dy togerët u strehuan në Limjan, tek shtëpia e Xhelil Zemzades,

LETRA E MIRËNJOHJES E AMBASADËS BRITANIKE NË TIRANË

Certifikatën e Mirënjohjes si dhe letrën e ambasadës angleze në Tiranë e solli vetë atashu ushtarak pranë ambasadës, nënkolonel Devis Strong, të cilën ia dorëzoi djalit të Xhelilit, Adem Zemzade në një ceremoni solemne. Dhe ja se çfarë thotë letra:

"I nderuar Zoti Zemzadja!

Ju faleminderit për letrën tuaj, dërguar nëpërmjet Bashkisë Dibrë.

Ju shkruaj në emër të Mbretërisë së Bashkuar për t'ju përcjellë falenderimet tona të sinqerta dhe respektin e thellë për ju dhe familjen tuaj, për shërbimin, guximin dhe sakrificën e përkthuesit në dëshminë tuaj.

Mbretëria e Bashkuar është e nderuar të njoh faktin që shtëpia e Xhelil Zemzades në Limjan shërbeu si bazë për forcat Aleate Britanike dhe Anglo-Amerikane që vepronin në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht midis gushtit 1943 dhe majit 1944.

Në një periudhë pushtimi dhe kur rreziku personal ishte gjithmonë i pranishëm, mbështetja e afruar nga familja juaj përfaqësonte një akt të jashtzakonshëm trimërie dhe solidariteti në mbështetje të çështjes aleate.

Veprimet si dhe sakrificat e tyre madhore e mëvonshme hedhin dritë mbi rreziqet e mëdha që mbartën familjet shqip-

tare, teksa zgjodhën të ishin në anën e lirisë.

Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria qëndruan krah për krah gjatë Luftës së Dytë Botërore, në luftën kundër fashizmit dhe okupatorit. Kjo histori e përbashkët lindi jo thjeshtë nga forcat ushtarake në uniformë por edhe nga guximi i civilëve dhe familjeve si e juaja, rezistenca dhe mbështetja e vazhdueshme e të cilëve mundësoi operacionet aleate.

Historia e familjes tuaj është një kujtesë e fuqishme e kësaj lidhjeje të qëndrueshme. Sot si aleat të NATO-s, Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria vazhdojnë të jenë e të qëndrojnë sëbashku në mbështetje të sigurisë kolektive, stabilitetit dhe vlerave të përbashkëta demokratike. Partneriteti ynë modern është një dëshmi e gjallë e miqësisë së krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe që mbështetet në brezat e rinj, siç e tregon qartë familja juaj.

Ju lutem pranoni falenderimet tona më të përzemërta teksa unë me mirësi ju shpreh respektin dhe mirënjohjen tonë për të gjithë antarët e familjes Zemzadja. Shërbimi dhe sakrificat e tyre mbeten një pjesë e rëndësishme e historisë së përbashkët midis dy kombeve tona dhe një simbol i çeliktë i forcës në marrëdhënjet tona midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë sot".

REAGIMI

Protesta e studentëve shqiptarë në RMV, media bullgare: Mickoski zgjodhi rrugën e intrigave politike

Shkupi përziën botën serbe me albanofobinë

Protesta e studentëve shqiptarë për gjuhën shqipe në Shkup, ku përveç atyre të Maqedonisë së Veriut, pjesë u bënë edhe ata nga Kosova e Shqipëria, ka marrë një vëmendje të madhe edhe jashtë RMV-së.

Media bullgare, BGNES nuk u kursye, duke e nisur artikullin e saj me titullin: “Shkupi përziën botën serbe me albanofobinë” dhe më pas vazhdon duke shkruar: “Mickoski zgjodhi rrugën e mashtrimeve politike”.

“Ditët e fundit, Maqedonia e Veriut ka qenë skenë e një krize politike, etnike dhe diplomatike që po thellohet. Kërkesa e studentëve shqiptarë të drejtësisë për të dhënë provimin shtetëror të jurisprudencës në gjuhën e tyre amtare është bërë katalizator për ngjarje që zbulojnë çarje të thella në shoqëri. Reagimet e aparatit shtetëror në Shkup – nga ndalimi i të rinjve pranë kufirit serb deri te një demarsh diplomatik – paraqesin një pamje shqetësuese të albanofobisë në rritje, të përzier me reflekset gjeopolitike nga e kaluara”, shkruhet në artikull.

Media bullgare vijon më pas me rolin e ambasadorit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Denion Meidanin, ku shkruan se ai u bë cak i presionit institucional dhe sulmeve të shëmtuara online. Ministria e Punëve të Jashtme në Shkup thirri misionin diplomatik shqiptar për të dhënë një demarsh verbal mbi deklaratat e Meidanit në mbështetje të protestave studentore.

Shkupi i përshkroi veprimet e tij si “ndërrhyrje të mundshme në punët e brendshme”. Faqet nacionaliste ma-



qedonase në mediat sociale shpërthyen me fyerje vulgare dhe thirrje që ambasadori të shkonte në shtëpi. U shfaqën informacione jozyrtare se Meidani do të tërhiqej herët nën presionin e VMRO-DPMNE dhe koalicionit Vredi, të cilët janë të pakënaqur me qëndrimin e tij aktiv mbi të drejtat e shqiptarëve.

Portali bullgar u ndal gjithashtu dhe te deklarata e shkrimtarit dhe publicistit Kim Mehmeti, duke e quajtur një thirrje skandalozë kur tha se shqiptarët duhet të ndalojnë së mësuari dhe foluri maqedonisht.

“Ekziston një mënyrë shumë praktike për të barazuar gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase: të sillemi tamam si bashkëqytetarët tanë maqedonas që nuk studiojnë dhe nuk flasin shqip... Të kemi institucionet tona, ku ata do

të vijnë me përkthyes në gjuhën e tyre, dhe ne do të vijmë tek ata me përkthyes në tonën.

Ndoshta ata që e duan vetëm shqipen e vdekur dhe që nuk duan një Maqedoni ku flitet edhe shqip, do ta kuptojnë vetëm këtë ‘gjuhë’! Dhe ndoshta vetëm në këtë mënyrë qarqet antishqiptare maqedonase do ta kuptojnë se mirësia jonë në njohjen e të gjitha karakteristikave të tyre etnike dhe gjuhësore nuk është dobësi, as nënshtrim ndaj autoriteteve maqedonase. Ndërkohë, duhet pranuar se sundimtarët maqedonas i trajtojnë shqiptarët këtu me përbuzje, sepse vasalët nga Vredi bëjnë politikë me pantallona ulur!”, tha Mehmeti.

“Ngjarjet e ditëve të fundit tregojnë qartë se përpjekjet për të shtypur të drejtat gjuhësore të shqiptarëve në

Maqedoninë e Veriut nuk çojnë në integrim, por në konflikte të ashpra. Kombinimi i arbitraritetit policor në kufij, drejtimi i qytetarëve të huaj në kufirin serb, skandaleve diplomatike dhe radikalizimit të diskursit publik krijon një precedent të rrezikshëm. Shkupi po merr rrezikun e zgjimit të fantazmave të vjetra të ndarjes etnike, duke përzier reflekset e një modeli të kaluar autoritar dhe pro-serb me albanofobinë e hapur institucionale”, shkruan BGNES.

Portali shton se simbioza midis shqipes dhe shërbimit ndaj interesave të huaja gjeopolitike është më qartësisht e dukshme në standardin e dyfishtë të qeverisë së Hristijan Mickoskit. Kërkesat e studentëve shqiptarë dhe mbështetja diplomatike për ta cilësohen si “ndërrhyrje e huaj” e rrezikshme, prandaj bllokohen kufijet dhe thirren ambasadorët, ndërsa në të njëjtën kohë Shkupi mbyll sytë ndaj operacionalizimit të drejtpërdrejtë të “Botës Serbe” në tokën maqedonase.

“Në vend të një përgjigjeje të vendosur shtetërore ndaj këtij rrjeti të huaj ndikimi, Kryeministri Mickoski zgjodhi rrugën e intrigave politike. I detyruar të komentonte mbi skandalin, ai u fsheh pas frazave boshe se qeveria “nuk ka ndërmend të ndërrhyjë në politikën e pavarura të vendeve të tjera”, duke e shfrytëzuar me nxitim rastin për të sulmuar përsëri opozitën shqiptare (BDI), duke e fajësuar atë për problemin 20-vjeçar të pazgjidhur të studentëve”, shkruan portali.

HISTORIA E FAMILJES ZEMZADE KU QËNDROI PËR NJË VIT MISIONI USHTARAK ANGLEZ



(Vijon nga faqja 4)

Në maj të vitit 1944 misioni anglez largohet nga shtëpia e Xhelil Zemzades me përshtypjet më të mira, por nga ajo ditë e sot humbën me të të gjitha kontaktet. Kjo periudhë kohe do të kishte mbetur në hije, do të kishte mbetur në kufijtë e legendës dhe gojëdhënës, po të mos interesohet herë pas here Adem Zemzade, djali i Xhilit.

Pas çlirimit të vendit shtëpia e Xhelil Zemzades nuk

U desh të kalonin vite me radhë dhe e vërteta të tregohet, jo skutave por në një institucion shtetëror siç është Prefektura e Qarkut Dibër. Pas kërkimeve të shumta, letrave e dokumentave që dispononte vetë Adem Zemzade, i biri i Xhelilit, më së fundi autoritete të Mbretërisë së Bashkuar u bindën se gjatë Luftës së Dytë Botërore, pikërisht në periudhën gusht 1943 - maj 1944, misioni anglez ka qëndruar në shtëpinë e Xhelil Zemzades në Limjan të Dibrës.

u vlerësua si bazë kryesore e Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare por përkundrazi u godit ashpër nga sistemi sa që lufta e klasave goditi pa mëshirë këtë familje të madhe, patriotike, atdhetare. Xhelil Zemzade priste të vlerësohej për gjestin human, bujar e patriotik por në fakt mori zhgënjimin. Arrestohet në prill të vitit 1946 dhe dënohet me 30 vite burgim. Në shtator të vitit 1946 arrestohet edhe Shefki Zemzade e dënohet me dhjetë vite burgim. Nuk qëndrojnë me kaq por familja e madhe Zemzade u përsëkutua për dyzet vite me radhë.

OBVLP MBËSHTET PROTESTËN E STUDENTËVE SHQIPTARË NË MAQEDONINË E VERIUT

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe Pastardhësve mbështet protestën e studentëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, kërkesa kryesore e të cilëve mbetet zhvillimi i provimit të jurisprudencës në gjuhën shqipe. Krrysië e OBVLP e konsideron këtë një të drejtë themelore dhe pjesë të garantuar të barazisë në arsim dhe administratë, duke theksuar rëndësinë e respektimit të gjuhës amtare në procesin e formimit profesional. Në mbështetje të tyre ka reaguar Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, e cila deklaroi se mbështetja e organizatës që ajo drejton ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave gjuhësore dhe arsimore, të cilat sipas saj janë fituar edhe përmes proceseve ndërkombëtare.

Ajo thekson se studentët shqiptarë nuk po kërkojnë privilegje, por zbatimin e një të drejte bazike për të studiuar dhe për t'u vlerësuar në gjuhën e tyre amtare, në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare.

Znj. Parllaku si ish-mësuese shembullore e gjuhës e letërsisë në disa shkolla shqiptare vlerëson se, gjuha përfaqëson një element thelbësor të identitetit dhe dinjitetit kombëtar, ndërsa shoqëritë demokratike maten nga mënyra se si trajtojnë komunitetet dhe garantojnë barazinë para ligjit. Ajo nënvizon se kërkesa e studentëve është legjitime dhe duhet të trajtohet me zbatim konkret të ligjit, jo me justifikime administrative.

REPORTAZH

SKËNDERBEGASIT NË VENDLINDJEN E SKËNDERBEUT PRIJËSIT TË MADH TË BASHKIMIT KOMBIT SHQIPTAR GJERGJ GJON KASTRIOTI SKËNDERBEU

Nga Kol.Trifon LLUPO*

Shkolla e mesme ushtarake "Skënderbej" e krijuar më 28 Marsin të vitit 1945, menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë nga fashisto-nazistët, hapi dyert dhe priti kontigjentin e parë të nxënësve nga radhët e ish partizanëve, ku veshjet e tyre në kuptimin figurativ "mbanin akoma" erën e barutit të pushkëve, aotomatikëve e mitrolozave të betejave me pushtuesit e fundit, që ishin nazistët hitlerian gjerman..

Shkolla e Mesme Ushtarake, e cila ishte Shkollë e Arsimit të Përgjithshëm, kryente edukimin mësimor-shkencor me Programin e Ministrisë Arsimit, unik për të gjitha Shkollat e arsimit të Përgjithshëm si dhe kishte programin e edukimit ushtarak, prandaj Sholla kishte dy Trupa pedagogjike mësimore, Trupen pedagogjike të mesuesve me Drejtorin e Shkollës si dhe Trupa edukimit ushtarak që drejtonte Komisari i Shkollës dhe për 47 vjet ishte Fidanishtja e përgatitjes së kuadrove drejtuese të Ushtrisë Shqiptare, një numër i konsiderueshëm aktualisht janë në Strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës Shqipërisë.

Për të mbajtur lart dhe të paharruar emrin e nderuar "Skënderbegas" tani pas përmbysjes së atij sistemi diktatorial socialist të Enver Hoxhës është krijuar Shoqata "Shkollës Ushtarake Skënderbej", e ligjruar edhe me Vendim të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Tiranës me kryetar Av. Adem Ajdinin, e cila në plotësim të misionit të saj vetëm gjatë këtij viti ka organizuar dhe ka zhvilluar dy aktivitete me shumë vlera për mbrojtjen dhe përkujtimin e ngjarjeve me vlera historike për Shkollën Ushtarake Skenderbej dhe për trashëgiminë historike të Kombit shqiptar.

Në vazhdim të realizimit të misionit historik që i ka ngarkuar vetes me Statutin e saj, më 6 Maj 2026, Shoqata "Shkolla Ushtarake Skënderbej" mori një sërë masash organizative për kremtimin me madhësi të Datës Historike për Kombin Shqiptar të 6 Majit 1405, të Shen Gjergjit, ditës së Lindjes së Kryeheroit të Kombit Shqiptar - Gjergj Gjon Kastriotit Skënderbe në bashkëpunim e bashkëorganizim me Bashkinë e Peshkopisë, me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandën e Akademisë Ushtarake, e cila dërgoi 4 studentë të Akademisë Ushtarake me zvkomandanin e Akademisë Ushtarake.

Në këtë ditë historike të përkujtimit të 621 vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit Skënderbe mori



pjesë edhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftërave për Liri e Pavarësi të Popullit Shqiptar, e përfaqësuar nga Nënkyetari i Organizatës Bashkuar të Veteranëve të Luftërave të Popullit Shqiptar, Kolonel, ish Skënderbegas Trifon Llupo dhe kryetari i Degës së Organizatës Bashkuar të Veteranëve të Luftërave të Popullit Shqiptar për Qarkun e Tiranës, Nënkolonel Hasan Shehu.

Unë kol.Trifon Llupo(autor i këtij rreportazhi), si ish skënderbegas dhe antar i Shoqatës së Shkollës Ushtarake Skënderbej përfaqësova në këtë aktivitet edhe villain, ish skënderbegas, Major Miço Llupo, i cili ka shërbyer si komandant repartesh ushtarake në Peshkopi, për 17 vjet.

Grupi i Shoqatës "Shkolla Ushtarake Skenderbe", u nis nga Tirana, nga Garnizoni "Skënderbeg" me mikrobuzin e vënë në dispozicion të aktivitetit nga Ministria e Mbrojtjes.

Grupin e kryesonte Kryetari i Shoqatës " Shkolla Ushtarake Skënderbej", Av. Adem Ajdini, i cili ishte dhe organizatori i këtij aktiviteti.

Në orën 09:00, sipas programit Grupi pasi përshkoi rrugën e bukur të Arbërit, që gjarpëron mes malesh e luginash mbritti në qytetin e Peshkopisë, ku u prit nga Kryetari i Bashkisë z. Rrahim Spahiu dhe pas përshëndetjes së Grupit me krytarin e stafin e Bashkisë u nisëm për në fshatin historik Sinë,

ku ka lindur Gjergj Kastrioti Skënderbe, në Familjen e Gjon Kastriotit, për të cilin është ngritur edhe një Muze që i kushtohet Gjergj Kastriotit. Një Muze modest, që ka nevojë të plotësohet me dokumenta të aktivitetit të Gjergj Kastriotit, të këtij Prijsi të madh, që zhvilloi një luftë titanike për afro 25 vjet, Gjergj Kastrioti Skënderbe i theu ushtritë e perandorisë osmane duke mbajtur të çliruar Shqipërinë por, edhe duke u bërë mburojë për mbrojtjen e Europës nga invazioni osman prandaj Gjergj Kastrioti nuk është një Prijsi i shqiptarëve por, ai bëri emër në gjithë Europën si një nga gjeneralët më të lavdishëm të kohrave dhe për Gjergj Kastriotin janë shkruar një numër i madh librash nga shumë historian e shkrimtar botëror.

Në Sinë, nën atmosferën e muzikës popullore dibranë, të Lodrës, të pranishmit vizitonin Muzeun duke shprehur vlersimet për punën që kishin bërë personalitetet dibranë, duke kontribuar edhe me investime konkrete për pasurimin me dokumente e armët skënderbegiane, shpatat, parzmoria, kokorja e çeliktë. Një surprizë në këtë ceremoni përkujtimore ishte edhe pjesmarraja e 4 kuadrove të Batalionit të 2. "Ruzhdi Salihi", me uniformën e UÇK-ës, me komandant Luanin, emri Luan ishte kodemri i përdorur gjatë Luftës së UÇK-ës .

Gjatë ceremonisë në Sinë përshëndetën historian, gazetari i investigativ për Historinë e Kombit Shqiptar, Marin Mema,, përshëndeti Kryetari i Bashkisë Rrahim Spahiu,, Komandaniti i Studentëve të Akademisë Ushtarake, Nënkolonel Nazmi Pana si dhe Kryetari i Shoqatës "Shkolla Ushtarake Skënderbe" Av. Adem Ajdini.

Pasi u krye vizita në Muzeun e Gjergj Kastriotit në Sinë vizitorët u nisën për në fshatin Kastriot, i cili trashëgon emrin e Kastriotëve ku është ngritur edhe memoriali i Gjergj Kastriotit Skënderbe. Këtë ceremoni në Kastriot e hapi me një fjalë përshëbde-tëse e falenderimi për gjithë të pranishmit kryplaku i fshatit Kastriot, pastaj e morën fjalën Komandanti i Studentëve të Akademisë Ushtarake të Forcave të Armatosura Nënkolonel Nazmi Pana, i cili përshëndeti pjesmarrësit edhe si bir i fshatit Kastriot.

Edhe këtu e tërhoqi në mënyrë të veçantë vëmendjen e gjithë të pranishmëve kur në shkallët e podiumit të Memorialit, të ngritur në kujtim të Gjergj Kastriotit, u ngjit me atë Emblemën e madhe të UÇK-ës në Kapelen-Beretë dhe në veshjen ushtarake, komandanti Batalionit të 2-të i UÇK-ës "Ruzhdi Salihi" me kodemrin e njohur gjatë Luftës UÇK-ës - Komandant Luani, i cili falenderoi gjithë të pranishmit

(Vijon në faqen 7)



ESSE

Invalidi i UÇK -së i fiksuar në një fotografi të në Sheshin “Skënderbej”?

Nga Sefer PASHA

Në rreshtin e parë të protestës kundër Gjykatës së Hagës në mbrojtje të komandantëve të UÇK -së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, mes qindra dhe mijëra vetëve, ishin dhe invalidët e betejave me serbët. Ata ishin shumë dhe nuk munda që t'i numëroja. Kur po fliste Alfred Moisiu munda të bëjë një foto me një nga këta invalidë, i cili që ulur në një stol dhe mezi mbahej mbi proteza. Fola me të. Nga tregimet e tij u trishtova. Ai më solli në sheshin “Skënderbej” betejet me serbët në Junik, Koshare, Gjakovë, Pashtrik dhe Reçak. Para se të gjymtohej nga predhat e serbëve invalidi kishte qenë një lis i gjatë. Ishte martuar me një grua gjithashtu të bukur si vetja. Pas tragjedisë ai dhe e shoqja e vuanin masakrimin. Invalidi nuk ishte më ai i pashmi i Prishtinës, që kur kalonte të gjithë kthenin kokën. Tek e dëgjoja rrëfimin e tij mu kujtua heroi Kanan Mazja, të cilin në Luftën e Vlorës të vitit 1920 italianët e plagosën dhe një plumb ja ndau më dysh nofullat e gojës. Pas operacionit Kanan Mazja kurrë nuk i bashkoi të dyja nofullat. Dhe populli i Vlorës kur e pa të gjymtuar i këndoi: -/Kanan Mazja nga Shkoza//Me një nofull copa - copa//Kanan tu prish bukuria//Le të rrojë Shqipëria//Shqipëria le të rrojë//Çka se mbeta unë pa gojë/.

E dëgjoja invalidin mes thirrjeve kundër padrejtësisë në gjykatën e Hagës dhe belbëzoja me vete se nuk kisha hasur motiv më ngjethës se sa ky i këtyre minutave mes këtij sheshi, që gjëmon nga brohoritjet për luftën e UÇK -së. Në ato çaste mua më ngjante sikur këndohej kënga e Kanan Mazes dhe e invalidit nga Prishtina. Njëra në Vlorë për trimin pa nofulla dhe tjetri në Reçak me këmbët të sharruara nga mitralozi i serbve. Në mes të brohoritjeve të mëdha mua më kërkuan që të bëja një fotografi me djalin e Hashim Thaçit dhe u largova. Por kur u ktheva invalidin nuk e gjeta më. E kishin marrë se ndjente dhimbje nga plagët e plumbave të serbve. U brenço-



sa. Unë do të shkruaja një reportazh, ku në qendër do të ishte kënga e Kanan Mazes dhe ajo e pashkruara për invalidin e Reçakut në sheshin “Skënderbej”. Po unë nuk i shënova dot as emrin i thashë vetes me sytë nga tribuna ku po fliste Ali Ahmeti. Ku ta gjeja mes mijëra njerëzve heroin e reportazhit tim? Në asnjë skicë të thjeshtë letrare nuk më kishte ndod-

hur një “aksident” kaq i çuditshëm. Më humbi emri i personazhit kryesor. Fabula nuk më duhej më. Dhe nisa të vrapojë pas invalidëve që ishin të shumtë. Dhe nuk munda që ta gjeja dot. Por më shpëtoj fotoja që kisha bërë më të. Foton do ta shpërndaja. Ku i dihet? Mbase do t'i bjer mikut tim dhe pastaj do të shkruajmë, jo një reportazh, por ndofta një roman.

SKËNDERBEGASIT NË VENDLINDJEN E SKËNDERBEUT PRIJËSIT TË MADH TË BASHKIMIT KOMBIT SHQIPTAR GJERGJ GJON KASTRIOTI SKËNDERBEU



(Vijon nga faqja 6)

por, edhe e ngriti lart entuziazmin e të pranishmëve, të cilët e përshëndetën me duartrokite të zjarrta fjalën e tij për vlerësimin që i bëri Heroit tonë Kombëtar Shqipëri-Kosovë dhe i gjithë Trojeve Arbërore. Kjo ditë përkujtimore e Dtlindjes

së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Gjon Kastrioti (Skënderbeu), u mbyll me Koncertin Festiv të organizuar nga Bashkia e Peshkopisë, ku edhe këtu nuk rreshtën vlersimet për këtë Prijës të mdh të Kombit Shqiptar, i cili jo vetëm që e mbrojti dhe e mbajti Shqipërinë për rreth 25 vjet të çliruar nga Perandoria Osmane por, ai u bë mburojë e pakapërcyeshme, duke mbrojtur edhe Europën nga pushtimi i Perandorisë Osmane.

Në këtë mbyllje të kësaj dite përkujtimore të lindjes së Prijësit të Madh,- Gjergj Kastrioti Skënderbej, u kërkua nga moderatorja e Programit dhe u ftua të përshëndeste kryetari i Shoqatës “Shkolla Ushtarake Skënderbej” Av. Adem Ajdini, cili falenderoi gjithë të pranishmit nga Qarku Dibër por edhe nga gjithë Shqipëria edhe emigrantë të ardhur enkas për këtë Festë, nga Europa edhe më larg, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë mbyllje të kësaj dite të shënuar të Shën Gjergjit, të 6 Majit 1405, në Sheshin qendror të Peshkopisë u dha një koncert me këngë e Valle nga Grupi Artistik i Qendrës Kulturorë “Haki Stërmilli”, i Bashkisë Peshkopi.

Këtij koncerti të bukur me këngë e valle patriotike, ia shumfishoi bukurinë dhe kënaqësinë pjesmarrësve, në këtë koncert kushtuar Gjergj Kastriotit, ardhja e Artistit të Madh të Skenës Teatrit dhe Kinemasë, aktori dhe regjizori i madh shqiptaro-maqedonas Xhevat Limani, i cili interpretoi me mjeshtëri autodialogun kushtuar Gjergj Kastriotit. Me mjeshtërinë e tij Xhevat Limani sikur na e solli aty të gjallë e të pranishëm Gjergj Kastriotin, me Veshjen, Shpatën e Përkrenaren e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Në mbyllje të këtij koncerti Bashkia shtroi edhe një drekë ku mori pjesë edhe Grupi i Skënderbëgasve të ardhur nga Tirana, për kremtimin e 6 Majit, dita e Shën Gjergjit, që është Ditëlindja e Gjergj Kastriotit Skënderbeu.

*Nënkrjetar i OBVL

HISTORIA

DOM SHTJEFËN KOSTANDIN GJEÇOVI

VEPRIMTAR I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Xhemal Meçi

Studiues & "Mjeshtër i Madh"

U lind në Janjevë të vilajetin e Prizrenit, i biri i Mati Gjeçovit dhe Prendës, i Pagëzuar me emrin Hilë;


Prejardhjen e hershme farefisë i tij e kishte nga Shala e Dukagjinit të Pultit prej ku u zhvendosen në Kryezi të Pukës. Prindërit e dërguan më 1884 në kolegjin françeskan të Troshanit, në Vilajetin e Shkodrës, ku mori mësimet e para të rrugës së meshtarisë.



Më 1920 u caktua famullitar në Vlorën e pushtuar nga italianët, i pambështetur nga kapelani ushtarak italian, u prit dhe u ndihmua nga Dom Mark Vasa. Më 1921 banoi në Shkodër, më 7 qershor 1923 u emërua sekretar i Provincës Françeskane. Më 1926 u caktua famullitar në Zym të Hasit, asokohe pjesë e Mbretërisë Jugosllave. Qe pjesë e një komiteti për pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve. Ngaqë nuk e ndërpreu as mësimdhënien e shqipes pas mbylljes së atyre pak shkollave nga autoritetet jugosllave, as punën e tij për mbledhjen e folklorit dhe ekspeditave arkeologjike, i irritoi autoritetet jugosllave dhe e vranë në në Kodër Rrezina më 14 tetor 1929. Vrasja e tij u pa

edhe si rast i fanatizmit të ortodoksisë serbe ndaj katolikëve. Trupi iu bart nga sivëllau i tij françeskan Lorenc Mitroviq përbrinjë dëshmorit tjetër të atdheut, Luigj Paliq.

AT.GJERGJ FISHTA PËR GJEÇOVI-KRYEZIU



Paralelisht me shërbimin meshtarak, ai mblodhi traditat e Shqipërisë Veriore, rrafshit të Mirditës dhe Alpeve Shqiptare, poezinë popullore të malësive, zakonet e të drejtës popullore dhe lëndë etnografike. I raportoi rregullisht kërkimet e tij duke botuar materiale etnografike, arkeologjike dhe histori lokale nëpër të përkohshme të ndryshme të kohës. Ka qenë i pari folklorist shqiptar që ndërmori punë kërkimore në terren sipas kritereve metodologjike të kohës. Përvoja e tij zë fill në periudhën studentore në Bosnje me një punim historik mbi Arqipeshkvinë e Tivarit bashkëautor me sivëllaun Lovro Mihaçević, duke punuar të paktën

gjashtëmbëdhjetë faqet e para me titullin në latinisht Metropolis Antibarensis. Botimet e para të Gjeçovit janë dymbëdhjetë poezi tek "Albania" e Konicës me emër pende Lkëni i Hasit.

ARKEOLOGJIA

Sa i përket shkrimeve arkeologjike, veçohet shkrimi Trashigime thrako-ilirjane botuar po te "Hylli" më 1924. Sipas ditarit të Shuteriqit, më 1924 së bashku me Simon Shuteriqin zbuluan këmbanën e Sopotit të Bërzeshitës. Në Ekspozitën Misionare Botërore të Françeskanëve të hapur më 1925 në Vatikan, Provinca Françeskane Shqiptare u përfaqësua me elemente nga koleksioni arkeologjik i Gjeçovit.

Koleksioni i tij u organizua më tej si muze në mjediset e kuvendit françeskan në Shkodër.

PROF. DR. BERNARD ZOTAJ PËR SHTJEFËN GJEÇOVI-KRYEZIU


Nga shoqata e historianëve ushtarakë të Shqipërisë u përgatitën dokumentat sipas ligjit dhe u shpall dëshmorë At Shtjefën Gjeçovi (Mëhill Gjeçi-Kryeziu). At Shtjefën Kostandin Gjeçovi veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, frat françeskan, etnolog, arkeolog, poet e shkrimtar i spikatur, filozof, përhapës



Prof. Dr. Bernard Zotaj
Kryetar i Shoqatës së
"Historianëve Ushtarakë"

i shkollave shqipe në Shqipërinë e këtij Drinit dhe matanë Drinit, "Mësues i popullit", inisiator për unifikimin e gegërishtes me toskërishten, mbrojtës i paepur i sigurisë së qytetarëve të Vlorës përgjatë Luftës Kombëtare të Vlorës të 1920-ës dhe figurë me përmasa të madha kombëtare. Mëhill Gjeçi-Kryeziu është quajtur për 22 vjet, nga lindja e tij më 12.7.1874 deri më 29.6.1896, kur e ka ndryshuar emrin në Shtjefën Kostandin Gjeçovi, pasi përfundoi studimet e larta teologjike në Kreshevë të Dalmacisë dhe në rregjistrat françeskan zhduket emri Hilë Gjeçi dhe zëvendësohet me Shtjefën Konstantin Gjeçovi. Faik Konica e ka cilësuar Gjeçovin si, "njeri nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria", ndërsa albanologu austriak Norbert Jokli e ka quajtur, "punëtor i palodhur në fushën e letrave shqipe".

TONINI ALIA, Gjate periudhës 1987-1995 ka punuar si shef sektori në Gjegjan të Pukës. Në vitin 1995 ka punuar si administrator i kompanisë private të përpunimit të drurit "ARDENO" shpk. Në fakt, kompania "ARDENO" është themeluar në vitin 1993 dhe është ndër kompanitë e para private të shfrytëzimit dhe përpunimit të drurit në vend. Në vitin 1996 kompania "ARDENO" është certifikuar me ISO 9001-2008 të standarteve europiane.



TONIN ALIA
ALIAJT E KRYEZIUT (PUKË)
PARAARDHËS TË GJEÇOVI



Nga e majta Ndoc, Gjovalin, Tonin e Hil Alia, të cilët kanë mbledhur fakte për këtë monografi

Që kur u njohem më patë folur se i takon fisit së familjes Gjeçi, Alia, Kryeziu - Gjeçovit.

Për ta dëshmuar këtë Tonin Alia tash e disa vjet punoi në hulumtimin e argumenteve se vërtet i takon asaj loze.

Kësaj radhe Tonini na vjen me një material të thukët e me plot fotografi që konsideroj se janë të mjaftueshme për ta argumentuar së vërtet edhe ai (Tonini) është i familjes së Madhe dhe me nam. Dhe, hulumtimet që i bëri Tonini tashme i futi brenda kopertinave të një libri - "ALIAJT E KRYEZIUT (PUKË) - PARAARDHËS TË GJEÇOVI".

Frok KRISTAJ

Falëndërojmë Tonin Alinë, që për herë të parë na ofroi trugun gjenealogjik të Familjes Gjeçi, Alia, Kryeziu - Gjeçovi. Të lumte Tonin!



REPORTAZH

400 personalitete diplomatike, akademike, te letrave e publicistikës në festën jubilarë

RADIO "JEHONA E SHQIPES", 40 VJET ZË I SHQIPTARIZMËS NË BRUKSEL

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Salla moderne e RENAISSANCE BRUSSELS HOTEL, fare pranë selisë së BE, asnjëherë nuk ka qenë më e mbushur sesa të dielën e 10 Majit 2026, ku u organizua me tërë madhësinë e saj Festa jubilarë e 40-vjetorit të Radios Jehona e Shqipes në Bruksel.

Ftesës së themeluesit dhe drejtuesit aktual të kësaj radioje prestigjioze, Z.Sakip Skepi ju përgjigjën katërqind personalitete diplomatike, akademike, të letrave e publicistikës shqiptare, të cilët përjetuan momente nga më mbresëlënëset.

Që në nisje të këtij manifestimi të shkëlqyer, moderatori Defrim Methasani-ikonë e moderimit dhe dokumentarit televiziv, jo më kot e quajti këtë "Festa e gjuhës shqiptare". Sepse, nëse më 1909, Faik Konica krijoi këtu gazetën "ALBANIA", 77 vjet më pas, më 1986, Sakip Skepi, një tjetër patriot i madh shqiptar bëri që të jehoi këtu në zemër të Europës zëri i shqiptarizmit, duke themeluar radion "Jehona e Shqipes".

I edukuar me ndjenjat e flakta të atdhetarizmit nga babai i tij Lam Skepi, një personalitet emërdritur i Dibrës e gjithë Shqipërisë, Sakipi mundësoi, jo thjeshtë përhapjen në valët radiofonike, por nëpërmjet radios "Jehona e Shqipes", mbajti gjallë rrënjët e fisit e të familjeve të para të Dibrës e gjithë Shqipërisë, si dhe të diasporës shqiptare.

Për katër orë të asaj mbrëmjeje të paharruar kjo radio jehoi si 40 vjet më parë.

PAK HISTORI...

Dyzet vjet më parë, më 23 shkurt 1986 Sakip Skepi do të njoftonte të gjithë bashkatdhetarët për nisjen e emisionit të parë...



Sigurisht që çështja kombëtare shqiptare zinte vendin kryesor në emisionet javore të radios. Po ashtu Festa e flamurit kombëtar shqiptar ishte një përparësi për radion...Kur diktatura komuniste po dridhej dhe për protagonistët e radios "Jehona e Shqipes" ishte një shpresë. Me rënien e Murit të Berlinit më 1 Nëntor 1988 lindi shpresa e madhe...E kështu radioja frymëzonte organizimin e manifestimeve gjigande para institucioneve evropiane duke u bërë promotore e ndryshimeve që pasuan në Shqipëri dhe në Kosovë. Ajo ju bëri jehonë zhvillimeve demokratike të pas '90-tës në Shqipëri dhe luftës ngadhënjimtare të UÇK e ndërhyrjes së NATO-kundër bandës së kasapit të Ballkanit Millosheviç. "Radio Jehona e Shqipes lindi për një kauzë dhe për një identitet ku dëshmoj se rruga e promovuar në tërë këto vite ishte e drejtë dhe e shenjtë. Lufta jonë ka qenë e pastër dhe hyjnore. E mbushur me



shpresë për një jetë më të mirë dhe një dritë për kombin tonë në familjen perëndimore", thotë ndër të tjera Sakip Skepi.

PROGRAM SPECIAL PËR 40 VJETORIN E RADIOS

Fillimisht një program special, ku nën drejtimin me kompetencë e profesionalizëm të Drejtorit Skepi, sollën mesazhet falenderuese pena të mirënjohura të publicistikës shqiptare, si: Aleksandër Çipa (president i Unionit të gazetarëve shqiptarë); Jordan e Alban Daci, Mentor Nazarko, Ergys Mertiri, Agim Baçi, Basir Çollaku, Muharrem Gjoka (Mjeshtër i Madh & President i Ansambllit Artistik



"Hazis Ndreu" - "Nderi i Kombit); Everest Beqiri, Halil Rama e Mina Hysa.

Fjalë zemre për drejtorin Sakip Skepi, edhe bashkëmoderatorët, gazetarë profesionistë të kësaj radioje: Enida Rrapaj, Spartak Fikaj e Flavia Kuçi.

Flavia që prej një viti ka patur privilegjin të flasë në mikrofonin e radios "Jehona e Shqipes", duke përcjellë tek dëgjuesit bukurinë e fjalës shqipe, ndihet vërtet e privilegjuar dhe e përkëdhelur nga fati për të folur nga kjo skenë në emër të stafit të kësaj radioje, për të vlerësuar disa prej protagonistëve të medias shqiptare, të cilët me kontributin dhe praninë e tyre kanë lënë gjurmë edhe në mikrofonin e "Jehona e Shqipes". Prania dhe zëri i tyre kanë pasuruar jo vetëm programet, por edhe lidhjet shpirtërore me publikun shqiptar në diasporë. Madhështia e kësaj radioje ka një emër të spikatur. Ai është Sakip Skepi që i ka dhënë asaj dimensionet e



"Jehona e Shqipes" e themeluar dhe drejtuar për 40 vjet nga patrioti Sakip Skepi, ishte dhe është jo thjeshtë një program radiofonik. Në 40 vjet ajo transmetoi 250 mijë minuta në gjuhën shqipe, duke u bërë zëdhënëse reale e diasporës shqiptare të Belgjikës

një media me vizion bashkëkohorë perëndimor, njeriu që i dha jetë këtij zëri për 40 vite, duke u bërë zëdhënësen më reale të protestave të studentëve kosovarë në vitet '80 dhe UÇK - në pas 1998; e rezistencës së patriotëve shqiptarë kundër diktaturës komuniste dhe frymëzuese e shndrrimeve epokale në Shqipërinë e pas 1990-s dhe e rrugëtimit të saj të suksesshëm drejt Europës së Bashkuar, drejt perëndimit.

Ndaj dhe Ministri për Evropën e Punët e Jashtme i Shqipërisë Ferit Hoxha, deklaroi në këtë mbrëmje festive unike se nuk do të lënë gjë pa bërë që Shqipëria të bëhet pjesë e BE.

Ai vlerësoi kontributin e kësaj radioje e veçanërisht të Drejtorit të saj Sakip Skepi, sepse ajo ka jehuar shqip në Bruksel



për 40 vjet, ka zhbërë kufijtë duke ruajtur identitetin shqiptar. Dhe kjo sipas tij nuk ndodh vetiu, ajo kërkon përkushtim.

Sakip Skepi me miqtë e tij idealistë shqiptarë si: Idriz Basha, Durak Duraku, Gani Sheta, Naim Lika e Musa Ukaj që janë historia e gjallë e kësaj radioje këtu në Bruksel, guxuan në atë kohë dhe ruajtën kujtesën.

250 MIJË MINUTA EMISIONE NË GJUHËN SHQIPE...

"Jehona e Shqipes" ishte dhe është jo thjeshtë një program radiofonik. Në 40

vjet ajo transmetoi 250 mijë minuta në gjuhën shqipe, duke u bërë zëdhënëse reale e diasporës shqiptare, të cilën ministri Hoxha e konsideron "atdheu jashtë atdheut". Kështu edhe Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Jashtëm i Republikës së Kosovës GLAUF KONJUFCA, ndërsa uroi mikpritësit në këtë festë jubilarë, i shprehu mirënjohje të thellë artistit famoz Arif Vladi si zëri i gjenit që nuk plaket kurë. Sepse Arif Vladi sipas tij, në kohën më të errët të diktaturës komuniste u bë ura lidhëse mes mërgimtarëve dhe atdheut të tyre dhe frymëzuesi i luftëtarëve të UÇK.

Edhe në këtë event Arifi u duartroi gjatë interpretimit mjeshtëror të Hymnit kombëtar shqiptar dhe këngës që ai vetë kishte krijuar e kompozuar, kushtuar radios "Jehona e Shqipes".

Të pranishmit mirëpritën dhe u emocionuan nga falënderimet specifike të: Philippe Close-Bourgmestre de la Ville de Bruxelles dhe Bertin Mampaka-President du Parlament de la Region de Bruxelles - Capitale, si dhe të deputetes shqiptare në parlamentin belg Kristela Butyçi.

Më të larmishme e bënë këtë mbrëmje festive edhe vallarët e grupit të valleve "Shqiponjat e Brukselit" nën drejtimin e Emin e Diana Hasanit, që performuan valle karakteristike shqiptare. Qoftë dhe për organizimin në mënyrë perfekte të këtij eventi, Sakip Skepi meriton mirënjohjen e thellë, jo vetëm të 400 pjesëmarrësve në këtë ngjarje të rëndësishme festive, por të gjithë shqiptarëve të hapësirës mbarëshqiptare në botë, ashtu siç mirëpriti edhe titullin "Ambasador i Paqes" që iu dha në mbyllje të këtij eventi nga Federata e Paqes Universale Shqipëri.



HISTORIA

Brigada XV Sulmuese u pagëzua në Operacionin e Qershorit 1944



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Etapat luftarake të Brigadës XV Sulmuese Operacioni armik i Qershorit 1944 ende vazhdonte në Shqipërinë e Jugut. Mjaft krahina ku zhvilloheshin luftime, si në Opar e në Protopapë më 29 qershor 1944 nisi rrugën luftarake Brigada e XV Sulmuese (Br. XV S). Në inaugurim e sipër brigade vijoi luftimet. Përvoja që kishin fituar kuadrot dhe luftëtarët e batalioneve partizane e territorial të qarkut të Korçës, ishte e dukshme në batalionet "Fuat Babani", "Hakmarrje", "Skënder Çaçi", "Reshit Çollaku", "Tomori", "Rinia". E gjithë brigade në momentin e inaugurimit kishte gjithsej 750 luftëtarë. Veprimtaria luftarake e Br. XV S kaloi në disa etapa si në etapën e parë nga 29 qershori deri në 20 shtator 1944, ku zona e veprimeve luftarake ishte fusha e Korçës, rruga automobilistike Voskop-Pllaçë, Cangonjë-Pogradec-Qafa e Thanës, qyteti i Pogradecit dhe krahinat Gorë-Oparë. Në etapën e dytë nga 20 shtator deri më 30 shtator 1944, u bë marshimi i saj në rrugëkalimin Veliçan i Mokrës, Polis-Labinot me mision të veprimeve luftarake rruga automobilistike nga Qafa e Thanës deri në Xibrakë. Ndërsa në etapën e tretë e cila nisi më 1 tetori dhe vazhdoi deri më 17 nëntor 1944, ku zona e veprimeve luftarake u bë rruga automobilistike Librazhd-Elbasan-Qafa e Kërrabës dhe qyteti i Elbasanit.

GODITJE TË FORCAVE NAZISTE

Luftimi i parë i ashpër që kreu e gjithë brigada ishte goditja e forcave naziste në rrethinat e Pogradecit, të përqendruara kryesisht në grykën e Pogradecit, në minierën e Çervenakës, në Qafë Thanë dhe në fshatin Çëravë. Forcat naziste ishin të armatosura mirë, të mbrojtur në llogore e fortifikata dhe kishin municion të bollshëm. Por, sulmi partizan bëri që armiku të tërhiqet nga rajoni i Gëshenjave, pasi nuk i rezistoi sulmit të rrufeshëm të luftëtarëve. Batalioni i katërt i brigadës më 24 gusht 1944 sulmoi një autokolonë gjermane e cila vinte nga Struga për në drejtim të Elbasanit, ku në rajonin e Qukës, në fshatin Xhyrë, ju bë një pritë e organizuar mjaft mirë. Përpyekja ishte tepër e ashpër, pasi dhe një autokolonë nga

Elbasani i vjen në ndihmë forcave të ardhura nga Struga. Kështu që u godit njëkohësisht, pasi masat organizative ishin marrë më parë dhe luftëtarët kishin zënë pozicione kyçe të terrenit. Në pritë e cila vazhdoi dhe luftim trup me trup armiku pësoi dëme si në njerëz dhe në materiale. Mjaft makina dolën jashtë gatishmërisë si dhe u ka shumë municion. Në këtë aksion u kapën dhe mjaft dokumente gjermane. Më 30 gusht, forcat e Br. XV S hynë në Pogradec dhe të gjitha fshatrat buzë rrugës automobilistike nga Lini deri në Podgorie ishin



të çliuara. Natën e 24 shtatorit, forcat e batalionit të dytë dhe të tretë goditën një autokolonë që vinte nga Struga për në Elbasan i asgjësuar dhe shkatërruar plotësisht. Nazistëve gjermanë ju kapën sasi të madha me armë dhe municione, por dhe pati humbje në njerëz. Ditë më vonë Br. XV S kaloi lumin Shkumbin dhe u vendos në rajonin e Elbasanit, ku kreu disa goditje kundër forcave naziste. Shtabi i brigadës bëri përgatitjet e duhura, siguroi krahët dhe bëri planin luftarak për të sulmuar dhe çliuar qytetin e Elbasanit, ku ishin strehuar mbi 2.500 ushtarë e oficerë të nazist. Për çlirimin e qytetit sulmi filloi mbi objektin kryesor që ishte Ura e Zaranikës, lagja e Kishës dhe kazemat e Krastës. Batalioni i katërt veprimet luftarake i përqendroi në mbulimin e krahëve dhe sulmoi forcat armike njëkohësisht në Xibrakë dhe Labinot. Batalioni i dytë kishte për detyrë të pengonte lëvizjen e armikut në rrugën Elbasan-Tiranë. Sulmi filloi më 5 nëntor dhe pas dy ditë me luftime, batalioni i katërt paralizoi forcat e armikut në fortifikatat e vendosur në Xibrakë dhe në Labinot.

BRIGADË E PËRGATITUR PËR LUFTIME NË QYTET

Në të njëjtën kohë, forcat e batalionit të parë dhe të tretë, përparuan me luftime në drejtimet e parashikuara, duke bërë që qyteti i Elbasanit të rrethohej plotësisht prej tyre. Forcat armike u

përqendruan në rrethinat e Shkollës Normale. Forcat e brigadës organizuan një sulm të shpejt, duke njohur vendin, rrugët dhe shtëpitë rezistuese, e detyruan armikun të linte dhe qëndresën e fundit, duke u larguar në mënyrë të çrregullt në drejtim të Tiranës. Forcat naziste në udhëtimin e tyre për në Tiranë pësuan goditje nga forcat partizane që kishin zënë pritë në Bradashesh dhe në lartësitë e Qafës së Kërrabës. Më më 15 nëntor 1944 Elbasani e çliroi. Partizanët e brigadës kryen dhe detyra të tjera në interes të luftimeve të përg-

afro 4000 km katrore nga forcat reaksionare, shpartalloi dhe çarmatosi mbi 2.000 forca xhandaro-balliste në fushën e Korçës dhe në Zonën e Qukësit, zuri 72 rob gjermanë, dogji e shkatërroi mbi 200 makina të ndryshme të pushtuesit dhe kapi mjaft dokumente të rëndësishme ushtarake të pushtuesit, etj.

ROLI I KUADROVE DREJTUES

Një rol dhe veprimtari të rëndësishme në veprimtarinë luftarake të Br. XV S luajtën komandant Teki Koloneci, Hero i Popullit dhe komisari Shahin Ruka. Në brigadë luftuan dhe drejtuan dhe kuadro të tjerë drejtues si Meço Starja, Maço Çomo, Arzen Leskoviku, Llazi Stratobërdha e Endri Keko etj. Br. XV S përshkroi një faqe të lavdishme dhe si gjithë brigadat e tjera të UNÇSH, u bë tmerr për armikun dhe shpresë për popullin. Armiqtë dhe tradhtarët nuk e ndjenë asnjëherë veten të qetë, si në fortifikata apo në fushat e betejave si në Pogradec, Qafë Thanë, Librazhd, Mirakë, Xibrakë, Labinot, Elbasan dhe deri në Qafë Kërrabë, në afërsi të Tiranës. Më 18 nëntor 1944 brigada u rreshtua në Divizionin I Sulmues dhe u përqendrua në grykën e Delvinës me detyrë për mbrojtjen e kufirit shtetëror. Në këtë kohë brigade kishte rreth 1.200 luftëtarë. Populli i krahinave të Korçës, Pogradecit, Librazhdit dhe Elbasanit i kujtojnë me admirim dhe respekt heroizmat dhe trimëritë e partizanëve të kësaj brigade në këtë 74 vjetor të



jithshme, duke mbajtur në goditje të vazhdueshme trupat naziste në rrugën Elbasan-Qafa e Kërrabës dhe mori pjesë në çlirimin e Tiranës. Nga brigade ranë dëshmorë të atdheut 50 luftëtarë. Shumë prej tyre ishin kuadro si Istref Maka, Koço Boboshtica, Minosh Gjoka, Rahman Beragishti, Thomaidha Laçka dhe Shaniko Starja, etj. Gjatë luftimeve luftarake Br. XV S çliroi një sipërfaqe prej

krijimit të saj. Përmendoret, lapidarët dhe pllakate përkujtimore të ngritura në vendet ku u kryen luftime dhe aksione, flasin për guximin, për trimërinë e luftëtarëve, komandantëve dhe komisarëve të kësaj njësie lavdi madhe. Kujtimi dhe respekti për dëshmorët e kësaj brigade kanë mbetur pishtar në rrugën e demokracisë të Shqipërisë dhe të popullit.

OPINION

Kosova në NATO, kështjellë e interesave të SHBA në rajon

Gjeneral © Piro Ahmetaj

E kam ndjekur me vëmendje të shtuar rezolutën e prezantuar më 30 prill në Kongresin Amerikan nga kongresmeni republikan Keith Self, së bashku me dy kolegët e mirënjohur, Ritchie Torres dhe Mike Laëler, e cila në thelbin e saj argumenton rëndësinë strategjike që mbart për SHBA anëtarësimi i Kosovës në NATO!

Me këtë rast, nuk mund të mos shpreh revoltën, për të mos thënë neverinë, ndaj mungesës cinike të vëmendjes që mori nga politika e ditës, si dhe mediat në Prishtinë dhe Tiranë kjo rezolutë historike për ardhmërinë në NATO, si dhe interesat gjeopolitike të Kosovës.

Por në pamundësi për përgjigje të dedikuar studiove televizive, gazetave dhe portaleve të interesuara, në vijim gjeni përmbledhje rreth peshës gjeopolitike që mbart kjo rezolutë jo vetëm për anëtarësimin e Kosovës në NATO, paqen dhe stabilitetin demokratik të rajonit, por edhe për mbrojtjen e statusques/interesave gjeopolitike të SHBA në Ballkanin Perëndimor:

Nga njëra anë, konsideruar kohën, mjedisin e sigurisë si dhe përmbajtjen e “mençur”, citojmë: “..anëtarësimi i Kosovës në NATO do të shërbente si kundërpërgjigje e domosdoshme për të penguar përpjekjet armiqësore si dhe për të parandaluar shpërthimin e një katastrofe tjetër globale në Ballkan”,

Këtë rezolute e çmoj si: “konfirmim të besimit dhe peshës që mbart Republika e Kosovës për të mbrojtur supremacinë afatgjatë të SHBA ndaj Ruisë dhe Kinës, si dhe për të zhvilluar interesat gjeopolitike të USA në Ballkanin Perëndimor”.

Kështu, kjo rezolutë, që e sheh anëtarësimin e Kosovës në NATO (krahas RSh) si qendrën e gravitetit, nuk është një akt i shkëputur i 3 kongresmenëve, as një rezolutë e ngjashme 1 vit më parë, por demonstron vendosmërinë strategjike të SHBA, si dhe projektin Trump-2: “Interesat e USA mbi gjithçka, amerikanët mbi të gjitha”!

Si shëmbull ilustrues të këtij zinxhiri vazhdimësie, mjafton të sjellim në kujtesë edhe “marreveshjen Trump-1”, nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në shtator 2020, ose paketën me: “njohjen nga Izraeli, autostradën e paqes Beograd-Prishtinë, Port në ujërat e thella të Adriatikut, etj”.

Nga ana tjetër, këtë rezolutë nuk e gjej kurrësi rrufe në qiell të hapur; as produkt të (pa) fuqisë së lobeve shqiptare në Washington DC



(të cila/ët përtej protagonizmit folklorik prodhojnë produkte shumë të dobëta), aq më pak si: “si qokë të SHBA ndaj kryeministrit në detyrë Kurti apo si dhuratë pa-fuqisë së konkurrentëve të pushtetit në Prishtinë”, POR si: “përgjegjësi të shtuar të Prishtinës zyrtare (imeditakisht edhe për Tiranën) për të tejkaluar krizën politike, luftën staliniste për pushtet, si dhe rikthimin e besimit të demokracia funksionale, ardhmëria euroatlantike e Kosovës si dhe interesave kombëtare (fatmirësisht) të ndërthurur edhe me interesat e SHBA në rajon dhe Mesdhe”.

Prandaj, duke përsëritur përlulen për gjakun e derdhur në shekuj, si dhe nderimin për sakrificat sublimë të shqiptarëve të Kosovës, nuk mund të mos e shtojmë edhe këtë rezolutë historike, ose mbështetjen (për anëtarësimin e Kosovës në NATO) në murin e mirënjohjes kombëtare ndaj “çlirimtarëve të vërtetë të Kosovës”, edhe për vetë peshën kritike që ato/SHBA-të vijnë ende të mbajnë jo vetëm për ardhmërinë euroatlantike të Kosovës, por edhe për bashkëjetesën paqësore dhe stabilitetin demokratik të rajonit.

Në shtesë, kjo rezolutë historike konfirmon Kosovën si qëndër të gravitetit/fortesë të SHBA-ve ndaj kundërshtarëve gjeopolitikë, ose armiqve potencialë (Kremlinit & Pekinit), shërben edhe si mesazh/ofertë Euroatlantike ndaj 4 vendeve anëtare të NATO-s që nuk kanë njohur ende Kosovën (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja), duke nën/mirëkuptuar faktin që pa votën e qoftë njërit prej tyre, anëtarësimi i Kosovës në NATO mbetet gjithësesi mision i pamundur.

Ndaj posaçërisht dalldosjes të

Vuçiç-it nga “marreveshja mes Krocisë, Kosovës dhe RSh”, mbështetja e SHBA për rritjen e fuqisë mbrojtëse (modernizimin e FSK me raketa Javelin), përfshi nga kjo rezolutë për anëtarësimin në NATO, shërbejnë edhe si një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj “armatosjes deri në dhëmbë të Serbisë”, me tanke, 18 Mig-29, 12 Rafale, Mi-35, raketa, dronë sulmi të gjeneratës së fundit etj!?. Gjithësesi, jo vetëm për oshilacionet e neo-milloshëviçëve në Beograd, më duhet ta përsëris edhe më qartë se: “për sa kohë të ketë prezencë të SHBA (Bondsteel), agresioni ushtarak kundër sovranitetit të Kosovës (njëherësh përgjegjësi e KFOR-it), përveçse aventurë vetëvrasëse mbetet mision tërësisht i pamundur”.

Në vijim, gjeni edhe: “pesë gjetje dhe rekomandime gjeo-strategjike”:

1) Anëtarësimi në NATO, mbrojtjen e sovranit të Kosovës, si dhe zhvillimin e interesave gjeopolitike (kombëtare) në rajon, 2 shtetet sovraane, pra RSh dhe Kosova, do mund t'i realizojnë vetëm duke forcuar më tej bashkëpunimin strategjik me SHBA. Kështu, edhe për Enveristët e vetëmbrojtjes sovraane, ngrihet një pyetje e thjeshtë: “Nëse përkundërt të mbështetjes së SHB, konfirmohet tërheqja e trupave ushtarake Amerikane/NATO nga Kosova (që sigurisht një ditë do të ndodhë), kush është opsioni 2 i Prishtinës zyrtare për të mbrojtur integritetin teritorial dhe interesat gjeopolitike të kombit”!?

2) Prishtina zyrtare nuk duhet kurrësi të ndërmarrë vendimarrje që minojnë themelet dhe klimën e (mirë) besimit me “çlirimtarët e

vërtetë”, pra me SHBA-të që ende mbajnë peshë kritike për paqen, sigurinë, stabilitetin demokratik, për ardhmërinë euroatlantike të Kosovës dhe interesat kombëtare.

3) Mbetet emergjencë nr. 1 ngritja e një “grupi të urtësh/ëise group”, me personalitete/elita të mirënjohura dhe gjerësisht pranura, që përtej luftës staliniste apo pazareve për pushtet, të përulen para interesave kombëtare dhe përgjegjësi shtetërore për ta jetësuar platformën: “2-shtete sovraane, 1-komb i vetëm”.

4) Për faktorët, aktorët dhe strategjistët/kolegët në Ëashington, do sugjeroja që perspektivën e dialogut Kosovë-Serbi ta para-kushtëzojnë jo me “deliret bolshevike të pushtetarëve që venë e vijnë”, por mbi një matricë masash të mirëbesimit reciprok (CSBM), me 3 kushtet e sipërpërmendura.

Së fundmi (5), besoj edhe më fort që kjo rezolutë, për rrjedhë anëtarësimi i Republikës së Kosovës në NATO, do të shërbejë jo vetëm si kontribut i shtuar për ndërtimin e paqes, bashkëjetesën paqësore, si dhe ardhmërinë euroatlantike (NATO/BE) të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe si “kështjellë e përparuar” për mbrojtjen e statusques si dhe promovimin e interesave amerikane në rajon dhe mesdhe.

Autori: Gjeneral © Piro Ahmetaj: Senior Ekspert për Sigurinë Kombëtare, Ballkanit si dhe marrëdhëniet me SHBA/NATO, Ish: zv/SHSHP, Këshilltar i Presidentit si dhe, Themelues i Përfaqësisë së RSh në SHAPE/NATO!

HOMAZH

Mbeti përherë, njeriu nga më të dashurit i Heroit të Popullit, Rrahman Parllaku

Novruz Zejnati, studiues i pasionuar, historian dhe shkrimtar i shquar

Me datën 17 mars, në moshën 86 vjeçare, në Prato të Italisë, pushoi së rrahuri zemra e kolonelit në rezervë Novruz Zejnati.

I lindur në Delvinë, ai mbeti shpejt jetim dhe e kaloi fëmijërinë te të afërmit e tij në Lazarat dhe në Shtëpinë e Fëmijëve në Gjirokastër. Më pas vazhdoi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" të cilën e kujtonte me nostalgji në çdo bisedë, dhe atë të Oficerëve në Tiranë, dhe filimisht shërbeu në repartet e K/A të Ishullit të Sazanit, ku u dallua për aftësi profesionale dhe përkushtim në detyrë. Duke parë cilësitë e tij si kuadër dhe vlerat të larta njerëzore, si mençurinë, ndershmërinë dhe besnikërinë, për një kohë, gjeneral Rrahman Parllaku e mori pranë vetes në Komandën e FUD - it, ku ishte Komisar, me komandant gjeneral Vaskë Gjinon.

Duke qenë i emëruar në repartet e Zbulimit, në përbërje të një grupi oficerësh, caktohet për të shkuar për eksperiencë në Vjetnam, ku aso kohe zhvilloheshin luftime intensive, përvojë të cilën më vonë e solli në librat që botoi. Kreu studimet në Akademinë Ushtarake në Fakultetin Gjitharmësh dhe pasi shërbeu me trupa, caktohet si oficer Drejtimi në Drejtorinë Operative të Ministrisë së Mbrojtjes.

Këtu, ai njihet nga afër dhe fiton respektin jo vetëm të drejtuesve kryesorë të kësaj ministrie, por edhe të kuadrove të reparteve e njësisive të ndryshme ushtarake.

I palodhur dhe përherë energjik dhe me shpirt krijues, Novruz Zejnati në moshën 32 vjeçare, caktohet komandant i Brigadës së Parë në Tiranë, çka nuk ishte aspak e lehtë, po të kemi parasysh rëndësinë e detyrës luftarake, efektivin aktiv dhe shtrirjen e madhe të saj, si dhe përballimin e kontrolleve të vazhdueshme të disiplinës, stërvitjes, gatishmërisë luftarake dhe zhvillimit të një morie mësimesh treguese dhe eksperimentuese. Por, pikërisht këtu u manifestua i gjithë talenti i tij i spikatur dhe takti për të krijuar lidhje të qëndrueshme me pushtetin vendor, si dhe institucionet prej nga kompletohej kjo Brigadë.

Kur në ushtri ndodhi goditja e të ashtuquajturit grup puçist, pa asnjë arsye, Novruzin e transferojnë po me këtë detyrë në Brigadën e Manzës, ku mori edhe familjen e tij, gruan Nexhmije dhe djemtë, Qamilin dhe Arturin. Ishte koha, kur ngarkesës iu shtuan edhe punimet fortifikuese - mbrojtëse të cilat së bashku me kuadrot e detashmentit i kryen me sukses të plotë.

Detyra e fundit e tij ishte ajo e Komandantit të Forcave Vullnetare të Durrësit, prej nga doli në pension me gradën e Kolonelit.

Novruz Zejnati ishte një studiues i pasionuar, një historian dhe shkrimtar që botoi shumë libra artistikë dhe monografikë, si ai kushtuar jetës dhe veprës së Ahmet Zogut apo Esat Pashë

• Ishte aq i dashuruar me profesionin e oficerit, sa me të drejtë shokët dhe miqtë e tij të shumtë, artistë, shkrimtarë dhe intelektualë të të gjitha profileve, e quanin ushtarak i lindur. I guximshëm dhe mendje hapur, ai me artikujt e botuar, ishte njëri nga mbështetësit pa rezerva të demokracisë në Shqipëri dhe reformës në ushtri, tani të orientuar nga Aleanca Atlantike



Toptanit. Me një kulturë të madhe, ai asnjëherë nuk reshti së shkruari rreth artit të luftimit, ku i ishte akorduar titulli doktor i shkencave në mbrojtjen e temës: "Veprimet luftarake për kalimin e pengesave ujore". Ishte aq i dashuruar me profesionin e oficerit, sa me të drejtë shokët dhe miqtë e tij të shumtë, artistë, shkrimtarë dhe intelektualë të të gjitha profileve, e quanin ushtarak i lindur.

I guximshëm dhe mendje hapur, ai me artikujt e botuar, ishte njëri nga mbështetësit pa rezerva të demokracisë në Shqipëri dhe reformës në ushtri, tani të orientuar nga Aleanca Atlantike. Ishte kjo arsyeja që ai mbeti përherë, njeriu nga më të dashurit i Heroit të Popullit, Rrahman Parllaku, i cili deri në fund të jetës ishte mik i afërt i familjes së tij.

Por janë virtytet e tij të rralla, kultura, thjeshtësia, zemërbardhësia dhe gatishmëria për të ndihmuar të tjerët, ato që e bënë atë një figurë të nderuar, jo vetëm në ushtri, por deri te qytetarët



e zakonshëm, pra te kushdo që e njohu nga afër. Ikja e Novruz Zejnati na pikëlloi të gjithëve dhe mungesa e tij do të ndihet gjatë mes nesh.

I paharruar kujtimi i jetës dhe veprës së tij!

Mikado Shakohoxha, Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, Halil Rama, Dhanil Raveli, Rifat Marsela, Vexhi Gjoni, Bujar Qesja, Cane Mehmetaj, Habil Zerani, Çelo Bora, Lefko Petrovski, Shpendi Topollaj

IN MEMORIAM

Lamtumirë miku dhe kolegu ynë Elmaz Leci

Nexhbedin Basha

Kolegu ynë i nderuar i shtypit ushtarak, Prof. Dr. Kolonel Elmaz Leci, është ndarë nga jeta disa ditë më parë.

Me largimin e tij, komuniteti i gazetarisë ushtarake dhe i publicistikës shqiptare humbet një zë të vyer, një studiues dhe intelektual që i kushtoi jetën fjalës së shkruar, analizës dhe dokumentimit të zhvillimeve të rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Kolonel Elmaz Leci do të kujtohet si një personalitet me formim të thellë akademik, me përvojë të gjatë në

shtypin ushtarak dhe me një përkushtim të veçantë ndaj profesionalizmit, korrektësisë dhe etikës së komunikimit publik. Kontributi i tij mbetet pjesë e rëndësishme e historisë së këtij zhanri të gazetarisë në vendin tonë.

Ai ka drejtuar për disa vite shtypin ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes. Po ashtu ka mbajtur funksione të rëndësishme në këtë dikaster.

Është autor i disa librave dhe ka spikatur me dosier-ët për historikun e gjeneralëve shqiptarë, botuar në disa numra të të përditshmes më të madha shqiptare "Panorama".

Prof.dr. Elmaz Leci ka qenë për disa


vite Rektor i Universitetit të Durrësit.

Në këtë dhimbje të madhe, një boshllëk i pazëvendësueshëm mbetet për familjen e tij. Fëmijët e tij, Arta dhe Elgin, humbën babain e tyre të dashur, një njeri që për ta ishte jo vetëm prind, por edhe mbështetje, udhërrëfyes dhe shembull jete.

Humbja e tij është një plagë e rëndë për ta dhe për të gjithë të afërmit që e deshën dhe e respektoan.

Në këto momente dhimbjeje, shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve, kolegëve dhe të gjithë atyre që e kanë njohur dhe kanë punuar me të.

Qoftë i paharruar kujtimi i tij.



Homazh për patriotin dhe intelektualin Mehmet Qerim Fekollari (BENJA)



ZEF RROZHANI

Me oficerin Demir Fekollari ka kohë që njihemi, ushtarak i mirë dhe njeri i mrekullueshëm, model i njeriut që la kudo gjurmë të pashlyera mirësie. Një jetë të tërë mes banorëve të Zadrimës në Lezhë, u bë si biri ç'do fshati. Demiri i lindur dhe rritur në një familje të devotshme në Këlcyrë të Permetit, manifestoi kudo virtytet e trungut familiar. Ndaj oficerin e ri e donin dhe e vleronin të gjithë.

Në bisedat e zakonshme ai fliste për paraardhsit e fisit dhe familjes, dhe ishte krenar që ishte bir i tyre. Por ai në veçanti fliste për gjyshin e tij të paharruarin Mehmet Qerim Fekollarin (Benja), i lindur më 4.9.1880 në fshatin Benjë të Këlcyrës. Si një familje e etur për dije dhe kulturë i ati i Mehmetit shkriu çdo gjë për të arsimuar të birin. Mes shumë mundimesh ai mësoi shkrim dhe këndim duke u dalluar kudo. Shkollën e mesme e mbaroi në Janinë e Selanik, kurse atë për mësues e kreu në Stamboll. Mehmeti djalosh ju përkushtuar dijes. Përveç lëndëve mësimore ai u bë zotrues i gjuhës greke, frënge dhe angleze.

Në vitin 1905 deri në vitin 1920 për arsye ekonomike punoi në disa shtete si në Turqi, Greqi, Francë dhe Amerikë. Përvetësimi i disa gjuhëve ia hapi dyert kudo, falë korrektësës së tij në punë. Në Amerikë u aktivizua në Shoqatën "Vatra", aty u njoh dhe punoi me Fan Nolin e Faik Konicën, ku shkruante në gazetën "Diel-li". Aty ai u bë i njohur duke u vlerësuar për virtytet e larta atdhetare. Por dashuria për vendlindjen nuk e linite të qetë. Pas shumë këmbënguljesh të vazhdueshme të atyre kollosëve, Mehmeti në moshën dyzet vjeçare vendosi të kthehej në vendlindje.

Sapo erdhi këtu për kater vite me radhë punoi në Nënprefekturën e Këlcyrës, Nënprefekt në Gjirokastër e Prefekt në Kukës. Është për tu theksuar devotshmeria e tij në ato vende ku drejtonte, duke qendruar kurdoherë pranë halleve të shumta sepse vendi ishte nën thundrën e te huajve.

Ta krahasosh një Prefekt të sotëm me veturë moderne e zyra si parajsë, me atë të Mehmet Fekollarit duket si një ëndërr. Po i afrohem gati një shekull dhe gjurmët e tij në mendjet njerëzore nuk janë shuar nga jugu në veri. Në Shkurt të vitit 1944 mori pjesë në LANÇ ku u rradhit në Brigadën e 6-të Sulmuese me komisar Mustafa Motohitin, ku u ngarkua me detyra drejtuese të Luftës Antifashiste Çlirimtare, ku dha një kontribut të paçmueshëm në çdo drejtim.

Pas çlirimit në vitin 1945-1957 punoi si mësues në disa fshatra të Përmetit. Në çdo fshat ai punoi me devotshmëri duke përgaditur filiza të rinjë të dijshtëm për Shqipërinë. Shtatëdhjetë e shtatë vjet jetë ia kushtoi Atdheut dhe arsimit deri sa ndrroi jetë në vitin 1959. Për të përkujtuar këtë personalitet të mrekullueshëm, për kontributin e vyer që dha me shembullin e përkushtimit, Këshilli Bashkiak i Këlcyrës me dt. 28.3.2025 i dha titullin "Qytetar Nderi i Bashkisë Këlcyrë" me motivacionin: "Një nga mësuesit më të hershem të krahinës së Dëshnicës e të rrethit të Permetit që dha kontribute të veçanta në mësimdhënjen në shkollat e para në gjuhën shqipe pas vitit 1920, duke përhapur dije e kulturë në kushte të vështira, të prapambetjes arsimore, kulturore e shoqërore të vendit tonë".

Ndaj nipi i tij sot ushtarak i lartë ecën në gjurmët e atij burri të ditur dhe atdhetar.

IN MEMORIAM

Mbështetur te libri “Kush jam unë?!” i autores së rreth 70 librave, nga të cilat mbi 20 janë romane, e përkthyer në disa gjuhë të huaja

VILHELME VRANARI GRUAJA QË I SHNDËRROI VUAJTJET NË ART

SHPENDI TOPOLLA

Kur zemra e zjarrtë dhe e lodhur e shkrimtares emër madhe Vilhelme Vranari Haxhiraj (Vivra), pushoi së rrahuri, dhe ne një grup miqsh të saj nga Durrësi, shkruam në Vlorë për t'i dhënë lamtumirën e fundit, na bëri përshtypje fakti që asnjë nderim nuk i ishte rezervuar asaj nga ana e përfaqësuesve të pushtetit vendor.

Kishim menduar, se ashtu sikurse e meritonte, arkemorti me trupin e kësaj gruaje të rrallë dhe me kontribute jashtëzakonisht të mëdha në përpjekjet për liri e demokraci, do të vendosej në sallën e Pallatit të Kulturës a diku tjetër, ku do të organizohej ceremonia për kryerjen e homazheve nga ana e qytetarëve vlonjatë.

Ishte një varrim i thjeshtë, me pjesëmarrje masive, ku ndër të tjerë, përveç hoxhës mjaft elokuent, foli edhe deputeti i mirënjohur Bujar Leskaj i cili vuri në dukje vlerat intelektuale dhe atdhetare të kësaj zonje fisnike që pa asnjë mëdyshje, me krijimtarinë dhe veprimtarinë e saj, rreshtohet jo vetëm te gratë më të shquara të asaj treve, por edhe të gjithë Shqipërisë e Kombit mbarë. E trishtueshme shpërfillja zyrtare ndaj asaj që kishte ngritur në pedestal “Elitat e mohuara...” dhe kishte thënë për ta se: “... janë krenari e kombit mbarë! Lum shtetet që kanë ditur t'i vlerësojnë se, kanë pasuruar ndërgjegjen kombëtare dhe kanë madhuar emrin e atdheut të tyre... Ata janë “Truri” që udhëheq njerëzimin në rrugën e vërtetë të dijës, të mirësisë e të drejtësisë, të jetës së bukur...” Por fatkeqësisht, në vendin tonë edhe pas 35 vjetësh nga koha kur u shemb komunizmi, lufta e klasave, në forma të ndryshme, vijon. Vilhelmja ishte lindur në Kaninë, për të cilën Sami Frashëri shprehej se “...është vendi ku lindi aristokracia feudale në Evropën Juglindore”, kurse Ernest Koliqi do të vargëzonte: “Për Kaninën Perëndia, / Kur e pa si diell mbi det, / tha: / - Jo, nuk është nga veprat e mia. / Këtë mrekulli mbi tokë, / dikush tjetër e ka bërë, / do ketë qenë një tjetër Zot!” Dhe Vilhelmja ishte pinjolle e njëjës prej familjeve aristokrate, por që pushteti i vetëquajtur popullor, e shihte me sy të shtrembër. Ajo vetë kujton se kur ishte fëmijë, skuqej kur dikush i thosh: “Vogëlushe e di që je një Komnene?! Sepse stërgjyshja jote e herëshme,



ishte bija e perandorit bizantin Aleks Komnenit”. I kishin arrestuar dhe burgosur babanë, me pretekstin se nuk kishte paguar taksat dhe pasi u kishin marrë gjithçka, deri edhe shtëpinë dhe bibliotekën e pasur, i kishin degdisur në një kasolle, andej nga një fshat i Fierit. Ku te halla e ku te tezja, pasi kreu shkollën fillore, kreu edhe të mesmen dhe pavarësisht varfërisë, ushqyerjes me lakra pa vaj, dhe ndjenjës së fajit pa faj, duke shkëlqyer në mësim, nisi punë si mësuese në Armen, por u kujtuan se e bija e kujt “armiku” ishte dhe e larguan shpejt nga mësuësia.

Njërin xhaxha, Mynyrin e kishin futur në burg, pasi nuk kishte ngritur dollin për mustaqet e Stalinit. Edhe xhaxhanë tjetër që kishte qenë partizan dhe tani oficer, e liruan nga ushtria me arsyetimin banal se kishte kunatin në burg.

Fati e solli që ajo ta lidhë jetën me njeriun e kulturës, artistin Fitim Haxhiraj, që edhe ai, paradoksalisht vinte nga një familje e lidhur me luftën, por të shpallur kulak. Ishte harruar gjithçka kishte bërë familja e saj, duke strehuar partizanët, duke u dhuruar atyre kope të tëra bagëtish dhe kishte xhaxha Skënderin që kishte kryer studimet universitare pas “Harri Fullcit”, në Itali dhe kishte përfunduar në krematorët e nazistëve në Aushvic. Vetëm mirë kishin bërë dhe ja mosmirënjohja komuniste.

Nuk kishte sesi të harronte se i kishin internuar përsëri, dhe i kishin futur në një kasolle tjetër në Sherisht pa asnjë arsye, dhe kishte përjetuar fyerjet ndaj babait që u lirua pas 13 viteve burgim, kur edhe fëmijët i thërrisnin “Kulaku i qenit”.

Vilhelmja, pasi vuajti përbuzjen, varfërinë, punën e rëndë për të rritur fëmijët, pas shumë vitesh i dhanë të drejtën për të vazhduar studimet në fakultetin Histori - Gjeografi të cilin e mbaroi me rezultate shumë të mira. Por asnjëherë nuk iu fashit urrejtja për regjimin gjakatar të Enver Hoxhës, ndaj e priti me entuziazëm ardhjen e demokracisë, madje u bë një nga flamurtaret e triumfit të saj, duke punuar pa iu dridhur qerpiku për ndryshimin e mezipiturit.

Në librin me intervistat e saj me Gëzim Markun,


Vilhelmja rrëfen edhe zhgënjimin që përjetoi, pasi për të, e djathta nuk e gjeti veten edhe tani në periudhën e tranzicionit. Ajo vetë shprehet se: “U rrëzua statuja e Përbindëshit Enver Hoxha, por jo “Ai” dhe as ndikimi i tij si “udhëheqës i lavdishëm” nuk u rrëzua”. Madje, puna arriti deri atje sa në ngjarjet e 97 - ë, atë familjarisht e dënuan bandat, me vdekje. Por tani, ajo e kishte vrarë frikën, dhe vetëm shteron pyetjen: “A nuk është e turpshme që vazhdon Lufta e Klasave në 5 breza edhe sot në shekullin e XXI?” Mos vallë këtu qëndron edhe përgjigjja e asaj pyetjeje se përse shkrimtares Vilhelme Vranari, autores së rreth 70 librave, nga të cilat mbi 20 janë romane, e përkthyer në disa gjuhë të huaja, fitueses së shumë e shumë çmimeve kombëtare e ndërkombëtare, kritikes sypatrembur të mangësive tona dhe zërit buçitës për Kosovën, që sipas saj, për t'u ndarë me Serbinë, duhet të ndërrojë emrin nga Kosovo në Dardani, iu mohuan nderimet e duhura nga zyrtarët e Vlorës? Dhe pavarësisht rrugëtimit plot peripeci të fatit të saj, Vilhelmja në intervistat që ka dhënë, nuk lë pa analizuar atë që ndodhi me të gjithë popullin shqiptar gjatë viteve të gjata të diktaturës, sikurse nuk lë jashtë vëmendjes ngjarjet e Kosovës, apo padrejtësinë që i është bërë dhe po i bëhet popullsisë çame. Për më tepër, ajo analizon krimet në Kosovë, si nga ana e serbëve titistë ashtu edhe nga komunistët shqiptarë. Dhe për këtë, ajo ndalet tek e ashtuquajtura Masakra e Tivarit e 1 Prillit të vitit 1945, ku u vranë pa asnjë shkak rreth 4000 djem të Kosovës që u hodhën në një gropë. Dhe shqetësimi i saj është se këto krime nuk u dënuan asnjëherë.

Vetë ajo u angazhua si drejtuese e Lidhjes Demokratike të Gruas në Vlorë, ku u shqua për gjithë sa bëri për emancipimin e femrës në kushtet e reja politiko - shoqërore. Ajo e ka quajtur gruan embrion i njerëzimit dhe jep plot raste sesi disa gra shqiptare janë bërë shembull qysh nga mbretëresha Teutë e cila udhëhoqi Luftën e Dytë Ilir - romake, deri te Shote Galica. Në të gjithë shtrirjen e intervistave të saj, Vivra nuk lë pa përmendur plagën e sotme të kurbetit, për të cilin shkruan: “Eh, kurbeti... / I rëndë si vveri! / I huaj në dhe mbeti. / Atje... atje larg, / në vetmi malin e treti”. Në këtë libër, intervistuesi Gëzim Marku e pyet Vilhelmen edhe për krijimtarinë e saj të pasur letrare. Dhe këtu ka shumë për të thënë ajo, jo vetëm pse ka shkruar e botuar në shumë zhanre, por edhe se ka bindjen se “Arti që lë gjurmë buron katërcipërisht nga dhembja”. Duke e studiuar seriozisht krijimtarinë artistike të Vivrës, Prof. dr. Mujë Buçpapaj e ka përshkruar atë kështu: “Vilhelme Vrana është një penë e fuqishme dhe e veçantë e letërsisë shqipe. Ajo ka hedhur themelet e një profili të qartë autentik si prozatore moderne, duke shëruar shpirtat e humbur njerëzorë dhe kombin e saj nëpërmjet personazheve, të cilët mbajnë mbi vete fatet e shoqërisë sonë dhe sot”. Po ashtu, shumë drejtë e përshkruan atë edhe zoti Fatmir Terziu që thotë se: “Kur shoqet e saj ngjisin shkallët e politikës në Parlament, në Qeveri apo në institucione me ajër të kondicionuar, Vilhelmja zgjodhi rrugën e ëndrrës, krijimtarinë letrare. Dhe kjo i dha mundësi që duke punuar me ngulm deri në çastet e fundit, të gjejë vetveten e humbur, sikurse pohon vetë, në honet e pluhurosura të kohës.

Shkrimtarja Vilhelme Vranari, pikërisht në këto hone të ferrit nga kaloi, në “Fundrrugëtimin” e saj, e qetësoi shpirtin me besimin se brezat do ta vazhdojnë rrugën e të bukurës që ajo më së fundi e gjeti, prandaj do të pushojë e qetë varrezat publike, atje ku deshi vetë, pra: “Në këtë qytet, ku deti s'fle kur-rë, këtu dua të prehem”. Por dua të besoj se brezat që do të vinë, do të jenë edhe ata që do të dinë ta nderojnë atë ashtu sikurse e meriton, duke i ngritur në një shesh të Vlorës tonë heroike, bustin e saj të bronzit.



PROFIL




OFICER USHTRIE, NËPUNËS QEVERIE, GAZETAR, SHKRIMTAR, POET DHE KRITIK LETRAR

SAKIP CAMI NË LIBRIN “PORTRETE SHKRIMTARËSH” TË ZEKERIA IDRIZIT

Zekerija Idrizi: Nga libri im 10 vëllimësh shqip-anglisht “Portrete shkrimtarësh”

Sakip Cami lindi në Bulqizë më 6 shkurt 1954. Mesimet e para i kreu në Viçisht dhe Gjoricë të Dibrës. Shkollën e mesme të përgjithshme e kreu në qytetin e Laçit nga viti 1968 - 1972. Studimet ushtarake i përfundoi në vitin 1976 në Akademinë Ushtarake Tiranë. Ka shërbyer si oficer për 20 vjet me radhë në Burrel, Bulqizë, e Peshkopi ku ka njohur nga afër visaret popullore të Dibrës. Nga viti 1997 e deri në vitin 2003 ka shërbyer në Tiranë, në fillim në Forcat Ajrore e më pas redaktor në gazetën “Ushtria” (1999-2000) dhe specialist për shtypin, mediat dhe botimet. Nga viti (2001-2003) në Drejtorinë e Shtypit dhe informacionit në Ministrinë e Mbrojtjes. Shtator dhjetor 2003, redaktor lajmesh në KOHA TV. janar 2004 qershorë 2005 specialist për publicitetin dhe marrëdhëniet me median e publikun në kompaninë e sigurimeve “SIGMA”. qershor 2005 - shkurt 2006 specialist për emergjencat civile në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Tani është gazetar dhe shkrimtar i lirë. Ka marrë pjesë në disa stërvitje shumëkombëshe brenda dhe jashtë vendit si gazetar ushtarak dhe oficer shtypi e informacioni, në Turqi, Bullgari, Gjermani, Suedi, dhe SHBA. Është dekoruar me medaljen “Naim Frashëri” për krijimtarinë publicistike dhe letrare si dhe me urdhërin e Sherbimit Ushtarak të klasit të tretë për kontributin e tij në radhët e Forcave të Armatosura. Ka botuar qindra artikuj në organet e shtypit si ne gazetën “Luftëtari”, “Ushtria”, revistën “Mbrojtja”, “Policia”, gazetën “Shekulli”, Zëri i Popullit”, “Rilindja Demokratike”, “Albania”, “Republika”, “Telegraf”, “Veterani”, “Dibra”, “Bulqiza”, “Ushtima e Maleve”, “Kastriotet”, “Rruga e Arbërit” etj. Ka qenë redaktor i gazetës “Ushtria”, zv.kryeredaktor i gazetës lokale pluraliste “Bulqiza” gazetës së parë të këtij rrethi, kryeredaktor



i gazetës “Stebleva” etj. Ka redaktuar gjithashtu edhe disa libra me poezi dhe publicistikë. Është anëtar i Bashkimit të gazetarëve profesionistë të Shqipërisë. Sakip Cami është autor i afro pesëdhjetë veprave.

Brenda pesë viteve, poeti dhe publicist i njohur Sakip Cami ka botuar dy libra të të njëjtit profil, në të cilët rrëfëhet mjeshhtërisht filozofia popullore dibrane. “Rrëfime popullore dibrane” (2006) dhe “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit” (2010) janë dy libra të vyer që përcjellin tek lexuesi visare të Dibrës. Në këto dy libra gjen mishërim sentenca “Atdheu nis nga familja”.

Siç shkruan kritika letrare, Sakip Cami ka ngritur në art odën dibrane që është quajtur “Universiteti i Dibrës”, atëhere kur në Shqipëri nuk kishte as shkolla fillore. Madje siç shprehet recensenti, Hajri Mandri në paarthënjen e këtij libri: “Mendimi filozofik dhe mendimi estetik, në odat e Dibrës, transmentonin që nga e kaluara e herëshme, mesazhet përmes një forme origjinale. Këto janë rrëfenjat (tregime), ose siç u thotë populli “meselet”, të cilat, për nga gjuha, kompozicioni, simboli dhe alegoria, humori dhe ironia, hiperbolat dhe litotat, u shndërruan në një plat-

formë komunikimi për dibranët ose në një “shkollë” ku shpaloseshin idealet socialestetike, qëndrimet moralizuese e didaktike, rreth jetës e vdekjes, rreth familjes e integritetit të saj”. Pikërisht mbi këtë shtrat ndërtohen dhe librat e S.Camit “Rrëfime popullore dibrane” dhe “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit”, ku brenda një tematike shumë të gjerë dhe të larmishme rrëfëhet tradita, historia dhe heronjtë e Dibrës, por dhe ngjarje të ditës, të lidhura ngushtë me politikën, ekonominë e sjelljen e njerëzve në rrethana të caktuara.. Si askush tjetër, Sakip Cami në këto dy libra reflekton zgjuarsinë dibrane, maturinë e burrave të mençur te Dibrës, dashurinë për njerëzit, sakrificat, patriotizmin e shumë veti të tjera të çmuara ...

KA BOTUAR LIBRAT:

- “Vërshimet e Drinit” 1996, poezi.
- “Karateisti i vogël” 2000”, poezi për fëmijë
- “Ujëvara të përgjakura”, 2001, poezi.
- “Daullja bie për ato që kanë veshë” 2003, fabula dhe satira
- “Fshati i martirizuar” 2004, monografi.
- “ Drejt NATO-s” 2004 (Personalitete dhe gjeneralë te NATO-S flasin për Shqipërinë, artikuj publicistikë 1999-2003
- “Rrëfime popullore dibrane” (2006)
- “ Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit. 2010
- “ Muharrem Xhediku, kompozitor i tangos shqipëtare” me bashkëautor, Halil Rama 2010
- “ Rahman Parlaku, një legjendë ne kufirin e dy kohëve” me bashkëautor, Halil Rama 2014
- “ Bajram Ndreu i Zall-Dardhës, bir i shquar i një familje të madhe” me bashkëautor. Halil Rama 2016
- “ Memoria historike” dhe “Kazazët e Durrësit” të autorëve Sakip Cami e Halil Rama 2016
- “ Refleksione fëmijërie. 2018
- “111 POEZI”
- “Matura 72”, roman dhe,
- “Mos ma prekni lumin tim”, rrëfim historik për luftërat, ekzodet dhe epidemitë e viteve 1912-1921
- “Edhe unë kam të drejtat e mia : (vlersha për fëmijët e moshës 5-10 vjeç për të mësuar të drejtat e tyre) / Sakip Cami; Kreshnik Hoxhalli; Luljan Gina
- “Njeriu i mirë”
- “Dibra në luftën ANÇL”, 2019
- “Dibra ngjarje dhe luftëtarë”, 2022

Sakip Cami është edhe redaktor i shumë librave dhe ka publikuar dhe shumë artikuj studimorë e kritikoletrarë për vepra autorësh të ndryshëm.

Emri i tij është edhe në Enciklopedinë e Dibrës. Ka në botim edhe libra të tjerë.

NDERIMI

OBVLP DHE SHOQATA E AVIATORËVE SHQIPTARË, AKADEMI PËRKUJTIMORE NË 100-VJETORIN E LINDJES

EDIP OHRI, LEGJENDA që jetoi mes qiellit dhe vuajtjes



(Vijon nga faqja 2)

zëvendëskomandanti i Forcat Ajrore Shqiptare, kolonel Luan Sadiku, i cili vlerësoi kontributin e Edip Ohrit në ndërtimin e aviacionit shqiptar me dinjitet dhe frymë sakrifice.

Ndërsa gjeneral Astrit Jaupi, ish-komandant i Forcave Ajrore, solli kujtime për figurën e tij si një drejtues me autoritet të natyrshëm, kulturë ushtarake dhe përkushtim të rrallë.

Fjalët e ushtarakëve të lartë, nga drejtuesit aktualë të aviacionit deri te gjeneralët që kanë mbajtur mbi supë komandën e Forcave Ajrore, sollën jo vetëm kujtime, por edhe respektin institucional për njeriun që jetoi mes qiellit dhe flamurit."

Në mbyllje të Akademisë përkujtimore, e bija e tij Mira Ohri mbajti një fjalë të gjatë dhe shumë emocionale, ku falënderoi organizatorët dhe të pranishmit dhe ndau kujtime perso-

nale për të atin: "Ai nuk ishte vetëm një komandant i aviacionit, por një njeri që jetonte me përlulësi dhe dinjitet. Në familje ishte i qetë, i përkushtuar dhe gjithmonë këshillues. Bisedat me të mbeten të paharruara, sepse nuk ishin thjesht fjalë, por mësimet jete. Ai besonte te njeriu, te disiplina dhe te puna e ndershme. Edhe në momentet më të vështira të jetës së tij, nuk e humbi kurrë besimin te e drejta dhe te dinjiteti njerëzor. Për ne, fëmijët e tij, ai nuk është vetëm një figurë historike, por një baba që na mësoi si të qëndrojmë drejt në jetë."

Ajo shtoi se kjo akademi nuk është vetëm një përkujtim, por një akt mirënjohjeje që i jep kuptim trashëgimisë së tij shpirtërore dhe profesionale, duke theksuar se "vlerat e tij jetojnë sot përmes kujtimit, por edhe përmes përgjegjësisë që kemi për t'i përcjellë brezave".

Në fund, ajo që mbeti në sallë ishte

figura e Edip Ohri: njeriu që jetoi mes qiellit dhe vuajtjes, por që nuk u thye kurrë nga koha.

PAK HISTORI: NGA FLUTURIMET SUPERSONIKE TE QELITË E BURGJEVE

Në kujtesën e aviacionit shqiptar, Edip Ohri mbetet i lidhur pazgjidhshmërisht me qiellin dhe me historinë e formimit të Forcat Ajrore Shqiptare. Ai hyri në radhët e aviacionit në fillim të viteve '50, në periudhën kur po ndërtoheshin themelet e aviacionit ushtarak shqiptar, duke u formuar fillimisht në Jugosllavi dhe më pas në Bashkimin Sovjetik.

Në karrierën e tij ai fluturoi me avionët luftarakë me helikë të tipit JAK dhe PO, me avionët bombardues, me avionët gjuajtës me helikë, si dhe me brezin e avionëve reaktivë Mikoyan-Gurevich MiG-15 dhe MiG-17, deri te supersoniku MiG-19. Po ashtu, ai pilotoi helikopterët Mil Mi-1 dhe Mil Mi-4, si dhe avionët e transportit ushtarak.

Në total ai realizoi rreth 4000 orë fluturimi, duke mos e ndarë kurrë

përvojën ajrore nga detyra e tij drejtuese si komandant. Ishte ndër të paktët drejtues që e njihte aviacionin nga brenda kabinës së pilotit, aty ku aftësia teknike bashkohet me karakterin e njeriut përballë qiellit.

Por ky qiell ku ai u ngjiti me profesionalizëm dhe përkushtim të rrallë do të kishte edhe hijen e tij të rëndë historike. Në moshën 49-vjeçare, në kulmin e karrierës dhe të arritjeve të tij, u lirua nga detyra dhe më 16 tetor 1980 u arrestua, në ditën e lindjes së Enver Hoxha, me akuzën e rëndë politike për "tentativë për rrëzimin e pushtetit me terror".

Në janar të vitit 1981 u dënua me 14 vite burg politik. Fillimisht vuajti dënimin në Ballsh dhe Zejmen, ndërsa më pas në Burgu i Burrelit — një nga burgjet më të ashpra të kohës.

Kështu, rruga e tij u nda mes dy skajeve të forta të një jete: nga lartësitë e qiellit ku drejtonte avionët supersonikë, te thellësia e qelive ku provoi kufijtë e qëndrësës njerëzore. Dhe pikërisht ky kontrast e bën figurën e tij një nga më të veçantat në historinë e aviacionit shqiptar.